



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



RAPORTI VJETOR

2010

Shkurt 2011, Prishtinë

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE GJATË VITIT 2010	4
2. MBLEDHJET E KUVENDIT, EKZEKUTIVIT DHE TRUPAVE PUNUESE	6
3. AKTIVITETET E ZYRAVE.....	7
a. Zyra e prokurimit	7
b. Zyra për marrëdhënie me publikun	8
c. Zyra e përfaqësimit juridik.....	9
d. Zyra ligjore	9
e. Zyra për integritet evropiane	10
f. Zyra për auditim të brendshëm	10
g. Njësia për të drejtat e njeriut	11
h. Zyra për komunitete dhe kthim	11
4. DREJTORIA E ADMINISTRATËS	12
a. Sektori i punëve të përgjithshme dhe juridike – zyra e personelit	12
b. Sektori për punë të kuvendit dhe ekzekutivit	13
c. Sektori i bashkësisë lokale	14
d. Sektori teknik.....	14
e. Sektori i gjendjes civile.....	14
f. Zyra pritëse	15
a. Zyra për teknologji informatike	15
5. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE	16
6. DREJTORIA E ARSIMIT.....	19
a. Të dhëna për arsimin në Komunën e Prishtinës	19
b. Ngritja e infrastrukturës shkollore, sportive dhe furnizimet gjatë vitit 2010	19
c. Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor dhe aktivitete tjera	21
d. Shërbimi i administratës	22
e. Shërbimi i financave	22
7. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	22
a. Projektet kapitale 2010	23
b. Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme kulturore	23
c. Projektet e përkrahura me subvencione	24
d. Sektori për kulturë	24
e. Sektori për sport dhe rini.....	24
f. Institucionet vartëse të DKRS-së	25
8. DREJTORIA E FINANCEVE DHE PRONËS	26
a. Të hyrat vetanake.....	26
b. Shpenzimi i buxhetit	27
c. Sektori për buxhet dhe financa.....	28
d. Sektori i tatimit në pronë.....	28
e. Sektori i pronës	29
9. DREJTORIA E EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT	30
a. Sektori i Ekonomisë.....	30
b. Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural.....	30
c. Sektori i pylltarisë.....	32
10. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT.....	32
a. Sektori i urbanizmit	32
b. Sektori i ndërtimit	34
c. Sektori i mbrojtjes së mjedisit.....	35
d. Zhvillimi profesional i stafit	35

e.	Sektori i Legalizimit	35
11.	DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE	36
a.	Hartimi i detyrave projektuese	36
b.	Hartimi i projekteve dhe përgatitja për ofertim.....	37
c.	Projektet infrastrukturore	38
d.	Projektet e bartura më 2011	38
e.	Vëllimi fizik i projekteve të realizuara.....	40
f.	Shqyrtimi i kërkesave	40
12.	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM	41
a.	Sektori i Shërbimeve Publike.....	41
b.	Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit	43
13.	DREJTORIA E KADASTRIT	45
14.	DREJTORIA E INSPEKSIONIT	47
a.	Sektori i Tregut dhe i Bujqësisë.....	47
b.	Sektori i Ndërtimit	48
c.	Sektori Sanitar dhe Veterinar	48
d.	Sektori Komunal dhe i Komunikacionit	49

1. PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE GJATË VITIT 2010

Qeverisja komunale në fokusin e vet të punës ka pasur aktivitetet me rëndësi për zhvillimin e qëndrueshëm të komunës, si në aspektin e qeverisjes transparente dhe gjithëpërfshirëse ashtu edhe në aspektin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Si fushë shumë me rëndësi ka qenë bashkëpunimi ndër-komunal si dhe forcimi i lidhjeve ndërkombëtare dhe bashkëpunimit me organizata të rëndësishme ndërkombëtare. Në këtë aspekt puna është koordinuar me Asociacionin e Komunave të Kosovës por aktivitete janë zhvilluar edhe individualisht me komunat kryeqytetet në vende te ndryshme.

Buxheti: Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2010 ka pasur në dispozicion një buxhet prej 52.3 mil euro për të përmbushur nevojat e shumta të qytetarëve. Të hyrat vetanake janë realizuar në masën prej 97%, që është një realizim i kënaqshëm duke marrë parasysh se gjatë kësaj periudhe një pjesë e territorit dhe obliguesve tatimor janë bartur në komunën e re të Graçanicës. Janë realizuar 76% e shpenzimet buxhetore të parapara dhe pjesa tjetër është alokuar për projekte të cilat vazhdojnë të implementohen edhe në vitin 2011.

Promovimi i zhvillimit ekonomik: Prishtina vazhdon të mbetet vendi më atraktiv për investime në Kosovë. Janë lëshuar 3,620 leje pune, krahasuar me 2,431 në vitin 2009, që është një rritje prej 49%. Janë realizuar 27% më shumë të hyra për buxhetin komunal nga këto leje pune dhe aktivitete biznesore në Komunën e Prishtinës. Janë ndarë subvencione për projekte bujqësore dhe për zhvillim ekonomik në vlerë prej 184,369 euro. Megjithëse ende nuk është bartur nga MTI në komunë regjistrimi i bizneseve, komuna ka filluar projektin “One-Stop-Shop” mbështetur nga Komisioni Evropian për t’ju ofruar shërbime më të mira bizneseve dhe investitorëve. Është finalizuar plani rregullues për zonën ekonomike të Prishtinës dhe posa të definohet traseja e autostradës, plani do të dërgohet në Kuvendin Komunal për aprovim dhe pastaj do të zhvillohen procedurat dhe kriteret për vendosje të bizneseve në atë zonë. Me një angazhim gjatë gjithë vitit 2010, në fund të vitit Komuna e Prishtinës ka siguruar përkrahjen nga USAID për zhvillimin e studimeve të fizibilitetit për projekte të partneritetit publik-privat. Një ekip i tërë i ekspertëve të jashtëm dhe të brendshëm po punon intenzivisht në përgatitjen e këtyre studimeve për disa projekte të identifikuar nga komuna dhe rezultatet e para do të shihen në pjesën e parë të vitit 2011. Po ashtu, komuna me një grup të ekspertëve të USAID-it është duke punuar në identifikimin e mundësive sa i përket procedurave dhe rregulloreve komunale për përmirësimin e kushteve për zhvillimin e biznesit. Si rezultat i kësaj pune, gjatë vitit 2011 Komuna pritet të ndërmarrë një numër masash për përmirësimin e ambientit për biznes që do të përmirësojë rangimin e Kosovës në nivel ndërkombëtar sa i përket kushteve për zhvillimin e biznesit.

Administrata komunale: Administrata me një staf prej 722 shërbyesve civil (gjendja në fund të vitit) ka punuar në rritjen e efikasitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve duke i trajtuar 97% të të gjitha lëndëve që kanë arritur në komunë gjatë vitit 2010. Komuna gjatë vitit 2010 ka marrë përgjegjësi shtesë në fushën e menaxhimit të pyjeve dhe të asistencës sociale. Megjithëse buxheti për këto përgjegjësi shtesë është i caktuar nga niveli qëndror, komuna ka ndërmarrë hapa që të përmirësojë shërbimet në këto dy fusha duke qenë shumë më efikase në vendimet për ndarjen e asistencës sociale dhe në parandalimin e shkatërrimit të pyjeve përmes një mbikëqyrje më të mirë me involvimin edhe të qytetarëve dhe bashkësive lokale në zonat rurale.

Shëndetësia, arsimi dhe kultura: Janë riorganizuar institucionet e shëndetësisë primare dhe të asistencës sociale konform ligjeve të reja për të mundësuar një menaxhim më efikas të tyre. Është finalizuar blloku i banesave për rastet sociale dhe pritet që në fillim të vitit 2011 të vendosen familjet dhe po ashtu janë bërë përgatitjet për ndërtimin e një blloku të ri banesash për invalid, veteranë të luftës dhe familjet e dëshmorëve. Në arsim, përmes investimeve të shumta është rritur për 36% hapësira për kokë nxënësi (nga 1.10 m² në 1.50 m² për nxënës) duke ndikuar në eliminimin e ndërrimeve në shumë shkolla, zgjatjen e orëve të mësimit dhe rritjen e cilësisë. Janë ndërtuar 6 shkolla dhe 4 janë në ndërtim e sipër (pritet të finalizohen më 2011), 4 anekse të shkollave, 5 salla të edukatës fizike, 7 terrene sportive si dhe janë meremetuar disa objekte dhe oborre të shkollave. Komuna ka përkrahur krijuesit dhe sportistët në 265 projekte të ndryshme me një shumë prej 200,158 euro si dhe ka investuar në projekte kapitale të kulturës, siç është Biblioteka e Qytetit “Hivzi Sylejmani” dhe Qendra Rekreative e Fëmijëve në Gërmi.

Urbanizmi dhe infrastruktura: Komuna ka themeluar sektorin për legalizim të objekteve p aleje dhe ka pranuar 6,147 aplikacione. Me qëllim të informimit më të mirë të qytetarëve për procedurat e legalizimit të objekteve, komuna ka organizuar 9 takime me qytetarë në të gjithë komunën. Në muajin gusht 2010 është bërë fotografimi satelitor i Komunës së Prishtinës dhe të dhënat e siguruara do të përdoren në procesin e trajtimit të lëndëve. Gjatë vitit 2010, janë miratuar në Kuvend dy plane rregulluese, është bërë plotësim-ndryshimi i një plan rregullues dhe kanë qenë në proces të hartimit tri plane rregulluese. Është përmirësuar dukshëm infrastruktura rrugore, sidomos tek rrugët kryesore që janë shumë komplekse, që kërkojnë shumë investime dhe që janë nyjet kryesore të qytetit (siç është rr. Bill Clinton, rruga B, kolektori në fushën e Pajtit etj.). Komuna po punon ngushtë me GTZ gjermane dhe Agjencion Katastral të Kosovë në përmirësimin e shërbimeve të katastrit. Ka filluar së zbatuari projekti për katastrin etazhor dhe janë bërë përgatitjet për regjistrimin e katastrin nëntokësor.

Ndërmarrjet publike komunale: Është punuar ngushtë me Ndërmarrjet Publike Komunale (NPK) në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarë. Në fillim të vitit janë bërë ndryshimet e nevojshme në Komisionet e Aksionarëve e NPK-ve pas konstituimit të përbërjes së re të Kuvendit Komunal. Në vitin 2010, të gjitha NPK-të kanë raportuar para Kuvendit Komunal. Në bashkëpunim me komunat e tjera të regjionit të Prishtinës, është zgjedhur bordi i NPK Pastrimi. Përmes bashkëpunimit me NPK Hortikultura dhe NPK Pastrimi është përmirësuar mirëmbajtja e gjelbërimit dhe pastrimi i qytetit. NPK Termokos ballafaqohet me problemin e inkasimit dhe si rezultat komuna është dashur të intervenoj për të siguruar nxemje për institucionet shkollore. Kjo gjendje e rëndë e furnizimit me nxemje pritet të tejkalohet me projektin për ko-gjenerim me mbështetje të Bankës Gjermane për Zhvillim dhe Komisionit Evropian. NPK Trafiku urban është ristrukturuar dhe është nxjerrë rregullorja e re e linjave të trafikut urban në përputhje me nevojat e qytetarëve për transport urban, e cila ka filluar të zbatohet.

Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstitutional: Duke marrë në konsideratë veçoritë dhe karakteristikat e Komunës së Prishtinës si Kryeqytet i Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2010 janë zhvilluar aktivitete të veçanta në drejtim të krijimit të bashkëpunimit të mirëfilltë me institucionet qendrore me qëllim të krijimit të klimës së bashkëpunimit dhe të lehtësimit të funksionimit të institucioneve qendrore dhe Komunës së Prishtinës. Vlen të përmendet se Komuna e Prishtinës ka arritur që gjatë vitit 2010 të trajtoj me prioritet kërkesat e institucioneve qendrore për akomodim duke dhënë në shfrytëzim objekte dhe pronë të Komunës së Prishtinës për një periudhe kohore të caktuar. Me prioritet janë trajtuar

edhe kërkesat për dhënien e lejeve urbanistike dhe ndërtimore për objektet e institucioneve shtetërore. Me gjithë vullnetin e qeverisë komunale për bashkëpunim, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka arritur që obligimet e veta kushtetuese në raport me Komunën e Prishtinës t'i plotësoj. Si rezultat i kësaj, ka ngecur ligji për kryeqytetin i cili nuk është proceduar në Parlamentin e Kosovës dhe kjo ka pamundësuar krijimin e një baze më të mirë buxhetore për Komunën e Prishtinës dhe të një kapaciteti institucional ligjor më të lartë.

Transparenca, komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje: Qeverisja demokratike për Komunën e Prishtinës ka qenë një prioritet i punës së Kryetarit të kryeqytetit. Në këtë fushë në vazhdimësi është punuar në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje nëpërmjet organizimit të takimeve me grupe të veçanta për trajtimin e temave me interes për të përgjithshëm. Janë organizuar takime të rregullta me qytetarë për përgatitjen e buxhetit të komunës, ku janë identifikuar projektet nga vetë qytetarët dhe në konsultim me ta është përgatitur lista e projekteve prioritare. Po ashtu janë mbajtur takime me qytetarë për t'i informuar ata me çështjen e aplikimit për legalizimi të objekteve pa leje. Procesi i përgatitjes së planeve rregulluese gjithashtu ka kaluar nëpër një proces intensiv të diskutimit me qytetarë dhe me ekspertë. Kjo qasje ka krijuar një relacion të besimit dhe komunikimit efikas në mes të komunës dhe qytetarëve, që është shumë e rëndësishme për arritjen e efekteve maksimale dhe realizimin e projekteve më prioritare për jetën e qytetarëve.

Bashkëpunimi ndërkombëtar: Fokus i veçantë i Kryetarit të Komunës ka qenë edhe rritja dhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë drejtim janë zhvilluar aktivitete të shumta të Kryetarit dhe të përfaqësuesve komunal. Bashkëpunimi ndërkombëtar ka pasur fushat e veta specifike siç janë: zhvillimi ekonomik, shkëmbimi i përvojave, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, binjakëzimi me qytete të ndryshme, rritja e bashkëpunimit me qytetet me të cilat komuna e Prishtinës ka marrëveshje binjakëzimi etj. Gjatë vitit 2010, Kryetari i Komunës ka arritur që të ketë bashkëpunim të kënaqshëm me partner të rëndësishëm ndërkombëtar. Ky bashkëpunim është zhvilluar dhe avancuar duke u materializuar me vizita shumë të rëndësishme si në Turqi, Francë, Belgjikë, Austri, e shumë vende të tjera, si dhe vizita të partnerëve ndërkombëtar në Komunën e Prishtinës. Këto vizita janë bërë në vazhden e bashkëpunimit me Asociacionin e Komunave të Kosovës, po ashtu edhe në bashkëpunimin që Komuna e Prishtinës ka me komuna të veçanta nga vende të tjera. Gjatë vitit 2010 është nënshkruar marrëveshja për binjakëzim me Komunën Metropolitane të Bursës, në Bursë të Turqisë, është bërë një vizitë zyrtare dhe takim me kryetarin e Vjenës dhe vizitë në Hagë dhe takim me kryetarin e Hagës. Kanë pasuar mbështetja e Vjenës dhe Hagës me ofrim të ekspertizës për procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Zhvillimor Komunal të Prishtinës.

2. MBLEDHJET E KUVENDIT, EKZEKUTIVIT DHE TRUPAVE PUNUESE

Gjatë kësaj periudhe, organet komunale kanë mbajtur:

- 19 mbledhje të rregullta të Këshillit të Drejtorëve,
- 9 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa,
- 13 mbledhje të Kuvendit,
- 12 mbledhje të Komitetit për Komunitete,
- 7 mbledhje të Komitetit për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim,
- 2 mbledhje të Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Strehim,
- 7 mbledhje të Komitetit për Arsim, Kulturë dhe Sport,
- 5 mbledhje të Komitetit për Zhvillim Ekonomik,

- 4 mbledhje të Komitetit për Shërbime Publike,
- 3 mbledhje të Komitetit për Pronë,
- 1 mbledhje të Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim
- 5 mbledhje të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive,
- 1 mbledhje të Grupit komunal për kthim

Gjithashtu, janë mbajtur 24 mbledhje-tubime me qytetarë::

- 9 takime me qytetarë lidhur me diskutimet publike të planeve rregulluese,
- 6 tubime me qytetarë në qytet dhe në zonat rurale ku janë diskutuar propozimet e qytetarëve për projekte që duhet të përfshihen në buxhetin e vitit 2011,
- 2 debate me qytetarë të parapara me statutin e Komunës,
- 9 tubime me qytetarë rreth informimit të tyre për procesin e legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje,
- 1 tubim i qytetarëve me avokatin e popullit.

Kuvendi gjatë kësaj periudhe ka miratuar:

- Statutin e Kuvendit të Komunës;
- 9 Rregullore;
- 2 rregullore ne diskutim publik (rregullorja për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës në shërbimin civil komunal dhe Rregullorja për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të Komunës së Prishtinës);
- Raportet: Raportin vjetor për vitin 2009, raportin gjashtëmuor për vitin 2010 dhe 5 raporte të ndërmartjeve publike lokale dhe
- 36 vendime të ndryshme.

3. AKTIVITETET E ZYRAVE

a. Zyra e prokurimit

Gjatë vitit 2010, në bazë të kërkesave të Drejtorive janë kontraktuar punë, furnizime, shërbime dhe projekte në shumën prej 28,861,091.00 € Janë zhvilluar 296 aktivitete të prokurimit dhe prej tyre janë kontraktuar 252 aktivitete të vlerave të mëdha, të mesme, të vogla dhe me vlera shumë të vogla. Gjatë kësaj periudhe ka pasur 22 anulime kryesisht për shkak të mungesës së tre operatorëve ekonomik të përgjegjshëm si dhe 22 aktivitete kanë qenë në procedurë deri më datë 31.12.2010. Mbi 87% e prokurimeve kanë të bëjnë me investime kapitale. Te furnizimet, pozicioni më i madh është furnizimi me naftë për ngrohje për shkolla. Aktivitetet e kontraktuara prezantohen në tabelën në vijim, nga e cila mund të vërehet se ka rritje cilësore të parametrave më të rëndësishëm, krahasuar me vitin 2009. Pjesëmarrja e projekteve kapitale në vitin 2010 në prokurimet e përgjithshme është ngritur në 87.14% nga 82.10% sa ishte në vitin 2009.

Llojet e prokurimeve

	2010		2009	
- Projekte kapitale	25,150,969.00	87.14%	21,982,270	82.10 %
- Furnizime me mallra,	2,388,192.00	8.28 %	3,284,164	12.26 %
- Shërbime dhe projekte	1,321,930.00	4.58 %	1,510,546	5.64 %
Gjithsej	28,861,091.00	100 %	26,776,980	100 %

Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2010 vlera e prokurimeve është ngritur për 7.8%. Në vitin 2010 mbi 96% e prokurimeve të kontraktuara janë zhvilluar me procedure të hapur - tender publik. Procedurat e aplikuara të prokurimit për vitin 2010 janë paraqitur në vijim.

Lloji i procedurës

	Shuma	Përqindja
- Procedurë e hapur	27,859,915.00	96.53 %
- Aprovime nga APP - punë shtesë	657,985.00	2.28 %
- Kuotimet	312,222.00	1.08 %
- Vlera minimale nën 1000€	30,969.00	0.11 %
Gjithsej	28,861,091.00	100 %

Afër 60% e punëve, furnizimeve dhe projekteve të kontraktuara kanë qenë me vlerë të madhe derisa me vlerë të mesme kanë qenë 40% prej tyre. Përqindjet për kuotime dhe vlera minimale janë pothuaj të pa përfillshme.

Kontratat sipas vlerave

	shuma	Përqindja
- Vlera e madhe	16,967,365.00	58.79 %
- Vlera e mesme	11,550,535.00	40.02 %
- Kuotime	312,222.00	1.08 %
- Vlera min. nën 1000€	30,969.00	0.11 %
Gjithsej	28,861,091.00	100.0 %

Gjatë vitit 2010, në 4 raste operatorët ekonomik kanë ushtruar ankesa kundër vendimeve të Departamentit të Prokurimit. Në tri prej këtyre rasteve, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) i ka aprovuar zgjedhjet që i ka propozuar Komuna, ndërsa në një rast e ka aprovuar pjesërisht ankesën e një Operatori Ekonomik (OE) dhe ka kërkuar përsëritjen e aktivitetit të prokurimit. Departamenti i prokurimit në bazë të raporteve zyrtare të organeve mbikëqyrëse dhe komisioneve të pranimit, iu ka shqiptuar dënime operatorëve të pa përgjegjshëm ekonomik për vonesa në kryerjen e punëve.

b. Zyra për marrëdhënie me publikun

Kjo zyrë ka përcjell takimet protokollare të kryetarit dhe nënkryetarit të komunës, mbledhjet Kuvendit, të Këshillit të drejtorëve, dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa, me ç'rast përmes takimeve me mediat, komunikatave dhe prononcimeve është informuar opinioni publik. Zyra për Marrëdhënie me Publikun (ZMP) ka distribuuar për media numër të madh informatash, lajme, ftesa, komunikata, reagime dhe kumtesa për opinion, të cilat janë plasuar edhe në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës dhe në intranet. Gjatë vitit 2010, nga ZMP-ja janë organizuar konferenca për media, të cilat janë përcjell nga pothuajse të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara. Po ashtu, ZMP-ja ka qenë pjesë e organizimeve të ndryshme si debateve publike, përrurimeve, inaugurimeve dhe promovimeve të aktiviteteve të ndryshme.

ZMP-ja ka bashkëpunuar me Asociacionin e Komunave, MAPL-në, OJQ-të, KFOR-in, OSBE-në, dhe institucionet tjera vendore. Në kuadër të punës së saj të përditshme, kjo zyrë ka përcjell vazhdimisht shtypin ditor dhe mediat elektronike, dhe ka veçuar tekstet në faqet e gazetave ku shkruhet për komunën e Prishtinës, duke i ruajtur dhe arkivuar ato.

Përveç punëve të përditshme, zyra është përkujdesur edhe për funksionimin e ueb-faqes së Komunës së Prishtinës, e cila është avancuar dukshëm. Komunës së Prishtinës i është rezervuar hapësirë e kënaqshme në televizionet nacionale dhe kabllore, dhe në të gjitha gazetat ditore, për t'i prezantuar aktivitetet. Janë mbuluar nga mediat përgjithësisht të gjitha aktivitetet e kryetarit dhe të këshillit të drejtorëve, aktivitetet lidhur me rrënimet e objekteve pa leje, largimi i shitësve ambulant, rregullimi i infrastrukturës rrugore, shkollore, shëndetësore, shtimi i hapësirave publike etj.

c. Zyra e përfaqësimit juridik

Zyra e përfaqësimit juridik punon në mbrojtjen juridike të të drejtave dhe të interesave të Komunës dhe ushtron funksione tjera të përcaktuara me Ligjin mbi Avokaturën Publike. Kjo zyrë ka punuar në mbrojtjen më të plotë dhe më efikase të drejtave pasurore dhe të interesave të Komunës. Zyra ju ka dhënë vazhdimisht mendime juridike organeve të komunës. Zyra ka ushtruar të gjitha mjetet ligjore ndaj vendimeve gjyqësore në afatet e caktuara të cilat prekin interesin e komunës.

Megjithatë, dinamika e zgjedhjes së lëndëve nëpër gjykata nuk varet nga puna e kësaj zyre, por nga puna e Gjykatave dhe organeve të cilat zhvillojnë procedurat. Gjatë vitit 2010, kjo zyrë ka punuar në gjithsej 267 lëndë, prej të cilave 102 janë të bartura nga vitet paraprake dhe lëndë të reja janë 165. Për të gjitha këto lëndë, në këtë periudhë raportuese zyra ka marrë pjesë nëpër Gjykata në 417 seanca gjyqësore dhe gjatë kësaj kohe janë ushtruar 33 ankesa, 5 revizione, 5 kundërshtime, 6 padi, 1 kallëzim penale, 103 përgjigje në padi, 10 parashtresa, 2 propozime, 1 përgjigje në propozim, 1 përgjigje në revizion, 5 njoftime, dhe 146 kërkesa për shënime. Po ashtu, zyrës gjatë kësaj periudhe raportuese i kanë arritur 76 Aktgjykime, 90 Aktvendime, 23 ankesa, 3 revizione, 1 parashtresë, 4 propozime për ekzekutim.

Për nga natyra e kontesteve që i paraqiten kësaj zyre, lëndë civile-pronësore janë gjithsej 97, konteste pune 13, konteste administrative 44, procedura penale 7, procedura të jashtëzakonshme 5, konteste për kompensim borxhi 6, konteste për pagesën e pagave 59, konteste për kompensim dëmi 26, konteste për kompensim real për patundshmëri 5, kontest për pengim posedimi 1, dhe 4 lëndë ekzekutuese. Duke u nisur nga numri i gjithmbarshëm i lëndëve në procedurë dhe mënyrën e zhvillimit të procedurës gjatë periudhës raportuese kanë përfunduar si lëndë të kryera 47. Lidhur me lëndët të cilat janë në procedure e sipër kjo zyrë ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme duke përdorur mjetet juridike.

d. Zyra ligjore

Gjatë vitit 2011, zyra ligjore me 2 të punësuar ka punuar në:

- dhënie e këshillave, informacioneve për ekzekutivin, sektorët – zyrat, institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë dhe ndërmarrjet publike komunale si detyrë e përhershme;
- shqyrtimin e të gjitha propozim-vendimeve dhe rregulloreve, të cilat i janë dërguar zyrës nga ana e drejtorëve të drejtorive, të drejtorëve të institucioneve arsimore, shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale;
- prezencë aktive në grupin punues për hartimin dhe diskutimin publik për aktet normative - Statutit të Bibliotekës komunale “Hivzi Sylejmani”, Teatrit të qytetit “Dodona”, Qendrës kulturore të fëmijëve, Statutit të QKMF – së, Statutit të Qendrës së mjekësisë urgjente dhe Qendrës për punë sociale;

- zbatimin e Ligjit nr. 03/L - 04 për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008): në hartimin e Statutit të Komunës së Prishtinës, të Rregulloreve dhe Vendimeve komunale kompetencë e Kuvendit të Komunës;
- pjesëmarrje aktive në: Këshillin e Drejtorëve; Komitetet jo obligative, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës;
- pjesëmarrje në debate publike me qytetar të Komunës së Prishtinës (gjithsej 9) për sqarim të Rregullores për trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje;
- pjesëmarrje në takime të ndryshme në Shqipëri, Maqedoni dhe në komunat tjera të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me trupat punuese të Asociacionit të komunave;
- përpilimin e kontratave për shfrytëzim të tokës – objekteve, në pajtim me vendimet e miratuara në Kuvendin e Komunës;
- hartimin e vendimeve, urdhëresave kompetencë e Kryetarit të Komunës;
- publikimin e konkursit për Bordin e drejtorëve dhe të zyrtarëve të ndërmarrjeve publike dhe ndihmë tjetër në aplikim të dispozitave të Ligjit për ndërmarrjet publike.
- pjesëmarrje në grupe punuese në nivel të Qeverisë së Kosovës,
- përgatitjes për botim të përmbledhjes së Statutit dhe akteve normative të miratuara nga Kuvendi i Komunës, etj.

e. Zyra për integritet evropian

Duke u bazuar në fushë-veprimtarinë e punës së Zyrës Komunale për Integritet Evropian (ZKIE), në këtë periudhë është bërë raportimi i rregullt për Komisionin Evropian përmes MAPL-së në përputhje me Planin për Veprim të Partneritetit Evropian (PVPE). Po ashtu, në këtë periudhë janë mbajtur takimet e rregullta të Kolegjiut të Zyrtareve komunal për Integritet Evropian siç parashihen në PVPE. Në këtë vit janë mbajtur edhe dy trajnime të organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe nga Agjencioni Rajonal për Zhvillim-Lindje lidhur me strukturën e Bashkimit Evropian dhe qasja në fondet e IPA-së. Zyra ka prezantuar në Këshillin e Drejtorëve lidhur me veprimet dhe masat që duhet ndërmarrë të cilat parashihen në PVPE dhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010. Zyrtarja për Integritet Evropian ka marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara nga MAPL, Asociacioni i Komunave të Kosovës, KCSF dhe organizata të tjera që lidhen me çështjet e integriteteve evropiane. Po ashtu, zyra është angazhuar në përgatitjen e dy projekteve për aplikim në fondet e Komisionit Evropian: për menaxhimin e mbeturinave ku komuna ka qenë bartëse e projektit e mbështetur nga GTZ dhe projekti për One-Stop-Shop për mbështetje bizneseve përmes Qendrës për Themelimin të Bizneseve.

f. Zyra për auditim të brendshëm

Gjatë vitit 2010, zyra e auditimit të brendshëm ka zhvilluar disa aktivitete të auditimit dhe ka ofruar këshilla profesionale për drejtoritë komunale dhe institucionet e tjera të komunës. Zyra e auditimit të brendshëm ka përfunduar auditimin e të hyrave nga shëndetësia për vitet 2008-2009 në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale, si dhe ka filluar auditimin në Drejtorinë e Arsimit dhe në Njësinë e autoparkut, të cilat janë në proces dhe pritet të kryhen deri në fund të muaj janar të vitit 2011. Po në fillim të vitit 2010 zyra ka ofruar asistencë komitetit të auditimit të brendshëm në përgatitjen e procedurës së menaxhimit, regjistrimit dhe inventarizimit të pasurisë. Gjate këtij viti Njësia e auditimit ka ofruar edhe disa shërbime të tjera këshillimit për: Drejtorinë e Financave dhe Pronës,

Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Gjatë vitit 2010, stafi i auditimit të brendshëm ka marrë pjesë edhe në disa trajnime, të cilat i ka organizuar Njësia Qëndrore e Auditimit të Brendshëm në kuadër të MEF-it. Zyra ka bashkëpunuar me auditorët e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm gjatë auditimit të pasqyrave financiare të komunës për vitin 2009, si dhe ka bashkëpunuar me komisionin e caktuar nga Kryetari, për vlerësimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit.

g. Njësia për të drejtat e njeriut

Projektet e realizuara nga njësia për të drejtat e njeriut në vitin 2010 janë: projekti “Të drejtat e njeriut bazë e bashkëjetesës paqësore” dhe projekti “Aksioni regjional i shoqërisë Civile për ngritjen e vetëdijes dhe Tolerancës” si dhe trajnimet “Avokim dhe Lobim”, “Fushatë vetëdijesimi“, “Barazia Gjinore dhe Mjedisi i Qëndrueshëm” dhe “Pjesëmarrja e Grave në Jetën Publike Lokale” (të organizuara në bashkëpunim me OSBE). Është organizuar tryeza e rrumbullaket me temën “Pozita e femrës nëpër Komunitet e Kosovës”. Me rastin e hapjes së fushatës “Tetori – muaji i mundësive të barabarta profesionale për personat me aftësi të kufizuara” janë punësuar për 2 ditë 10 persona me aftësi të kufizuara. Për shënimin e “25 Nëntorit - Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas” është mbajtur seminar. Njësia për drejtat e njeriut gjithashtu ka pas takim me OJQ- lokale për hartimin e planit të veprimit. Koordinatorja e kësaj njësie ka marrë pjesë në komisione të ndryshme, në takime të rregullta të Agjencionit për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit si dhe në seminare, trajnime dhe konferenca të ndryshme ku ka prezantuar punën e saj dhe situatën e barazisë gjinore në Komunitetin e Prishtinës.

h. Zyra për komunitete dhe kthim

Gjatë vitit 2010, komunitetet minoritare kanë pasur qasje të mira në shërbimet publike në të gjitha institucionet komunale. Janë realizuar 10 takime me zyrtarët e OSCE-së ku është raportuar mbi punën dhe aktivitetet e zyrës komunale për kthime, strategjia komunale e kthimit 2010, kthimi i të zhvendosurve serbë në fshatin Kolovicë dhe pajisja e të zhvendosurve me dokumentacion personal e pronësorë nëpërmes të shërbimeve përkatëse komunale.

Gjatë vitit 2010, janë organizuar 15 takime me zyrtarët e UNHCR dhe KAAD në të cilat janë diskutuar organizimi i para vizitave dhe përgatitja për vizitat e të zhvendosurve pronave dhe shtëpive të tyre, vizita fshatave Slivovë, Bardhosh dhe Kolovicë, hartimi dhe aprovimi i strategjisë komunale të kthimit dhe shqyrtimi i kërkesave të të zhvendosurve për kthim. Zyrtarët për kthime kanë marrë pjesë në 12 takime të Komitetit për Komunitete në të cilat janë shqyrtuar kërkesat dhe ankesat e pjesëtarëve të komuniteteve, gjendjen e tyre ekonomike dhe të sigurisë. Janë organizuar 3 takime me Zyrtarët e MPB, MKK, MAPL dhe MPMS në të cilat janë shqyrtuar riorganizimi i zyrave të kthimit dhe të komuniteteve. Gjatë vitit 2010, UNHCR ka ndërtuar shtëpinë e të kthyerit Bajram Hajrolli (romë) në Rr. “Dalmatinska” dhe ka riparuar shtëpinë e të kthyerës Hamide Berisha (ashkali) në Rr. “Verat e Llukës”. MKK kanë ndërtuar shtëpi dy kate për Milaim Ramadanin e Bukurije Ramadanin në rr “Vëllezërit Fazliu” në “Kordën e Trimave” dhe të familjeve Bashkim, Dashnim e Xhemajl Akllapi në Rr. “Verat e Llukës” në. Gjatë vitit 2010 janë kthyer 5 familje ashkali, një familje rome dhe një kryefamiljare ashkali. Gjatë vitit 2010, nga ZKK, UNHCR dhe KAAD janë organizuar në teren 20 vizita pronave, shtëpive dhe banesave të zhvendosurve dhe të kthyerve. Me IOM-in janë organizuar 5 takime lidhur me zbatimin e projektit për zhvillimin e bashkësive për komunitetin serb të dy Bernicave, Bardhoshit dhe Lebanës. Gjatë

vitit 2010, zyrtarët për kthime kanë marrë pjesë në 4 seminare, 2 tryeza dhe 2 takime regjionale që lidhen me detyrat e tyre të punës.

Zyra e komuniteteve e Komunës së Prishtinës ka qenë me seli në Graçanicë. Kjo zyrë në fillim ka pasur mbi 20 punëtorë. Me formimin e Komunës së Graçanicës disa punëtorë janë sistemuar në këtë komunë, ndërsa një numër ka mbet pa u sistemuar. Sipas Rregullores 02/2010 të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për formimin e Zyrës së Komuniteteve dhe Kthimit si një zyrë e përbashkët ku janë paraparë 5 zyrtarë. Zyra për kthim ka tani dy zyrtarë të cilët që nga shtatori i vitit 2010 kanë kryer punët e zyrës për komunitete.

Në Komunën e Prishtinës, komunitetet minoritare kanë pasur qasje të mira në shërbimet publike në të gjitha institucionet komunale të ndihmuara nga zyra për komunitete dhe kthim dhe UNHCR. Të gjitha kërkesat e tyre janë shqyrtua nga kjo zyrë dhe Komiteti për Komunitete. Gjatë vitit 2010, zyra ju ka ndihmuar qytetarëve të Bërnicës së Poshtme ku jetojnë 130 familje serbe në infrastrukturë në asfaltimin dhe ndriçimin e rrugëve, ndihma në lëndë djegëse për çerdhen e fëmijëve, rregullimi i kanalizimit të shtëpisë së shëndetit, montimi i trafos të re të rrymës në Bardhosh si dhe fillimin e kanalizimit në fshatin Bërnicë e Poshtme. Këto janë disa projekte që sillen rreth 400,000 euro. Familjeve serbe ju kanë dhuruar dy makina për prodhimin e ushqimit të kafshëve. Gjatë vitit 2010, zyra për komunitete dhe kthim bashkë me Zëvendës Kryesuesin e Kuvendit për Komunitete z.Engin Beyoglu dy herë kanë vizitua fshatin Slivovë të banuar me komunitetin Serb ku janë identifikuar nevojat për investime në këtë lokalitet. Po ashtu dy herë është vizituar kisha Ortodokse “Sveti Nikolla” me kërkesë të kërërve të kishës lidhur me furnizimin me rrymë që është ndërprerë nga KEK-u, lidhjet telefonike si dhe pastrimit të varrezave të kishës.

4. DREJTORIA E ADMINISTRATËS

a. Sektori i punëve të përgjithshme dhe juridike – zyra e personelit

Gjatë viti 2010 ky sektor ka kryer punët siç janë: Rregullimin, sistemimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të shërbyesve civil, përpilimin e kontratave të punës, përgatitjen e vendimeve për pushime vjetore, ndërprerjen e marrëdhënies së punës etj. Në evidencën e zyrës së personelit (gjendja me 31 dhjetor 2010), si të punësuar kane qenë të regjistruara 722 shërbyes civil (më 2009 të punësuar kanë qenë 653).

Gjatë kësaj periudhe, janë pranuar në punë 32 shërbyes civil, kurse marrëdhënia e punës u është ndërprerë 39 shërbyesve civil, për arsye të ndryshme.

Gjatë vitit 2010, në bazë të marrëveshjeve me ministritë përkatëse, është bërë transferi i 76 punonjësve, të cilët kanë marrë statusin e shërbyesve civil të komunës, si vijon:

- 16 punonjës janë transferuar në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (përkatësisht në Bibliotekën “Hivzi Sylejmani” prej 1.1.2010) sipas marrëveshjes së mirëkuptimit të nënshkruara në mes MKRS, MAPL, MEF dhe Komunës,
- 11 shërbyes civil janë transferuar nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në Komunë (në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Zhvillimit prej 14.07.2010) për shkak të kalimit të kompetencave nga niveli qendror në komunë lidhur me menaxhimin e pyjeve.
- 49 shërbyes civil janë transferuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Social në Komunë (në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale) përmes marrëveshjes

e mirëkuptimit në mes të MPMS, MAPL, MEF dhe Komunës lidhur me kalimin e kompetencave për asistencë sociale nga niveli qendror në nivelin lokal.

Nga 39 shërbyes civil, marrëdhënia e punës iu është ndërprerë mbi këto baza::

- 16 janë larguar me dëshirë,
- 3 me komision disiplinor,
- 8 kanë lëshuar punën,
- 3 kanë vdekur,
- 9 shërbyes janë transferuar nga Komuna e Prishtinës (nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit) në Komunën e Graçanicës në bazë të marrëveshjes me Komunën e Graçanicës.

Struktura kualifikuese e shërbyesve civil është paraqitur në vijim.

Niveli arsimor

	Numri	%
Me fakultet	221	31%
Me shkolla e lartë	38	5%
Me shkolla e mesme	440	61%
Me shkolla fillore	23	3%
Gjithsej	722	100%

Struktura etnike e shërbyesve civil është: shqiptarë 668, serbë 44, turq 6, të tjerë 4. Struktura gjinore: 486 meshkuj dhe 236 femra.

b. Sektori për punë të kuvendit dhe ekzekutivit

Sektori për shërbime profesionale të Kuvendit për periudhën janar-dhjetor 2010, për Kuvend, Këshillin e Drejtorëve, komitete të Kuvendit dhe për komisione të ndryshme të Kuvendit, ka kryer këto punë:

- punë profesionale dhe administrative në përgatitjen e materialeve (rregulloret, vendimet etj.),
- bashkëpunim me drejtoritë komunale në hartimin e rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme,
- konsultime dhe ndihmë në miratimin e rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme,
- përgatitje të rregulloreve, vendimeve dhe akteve të tjera të miratuara nga organet e lartshënuara,
- përcjellje të zbatimit të vendimeve dhe rregulloreve të miratuara në Kuvend;
- përkthim, lektorim dhe shpërndarje të materialeve,
- hartim të ekstrakteve të mbledhjeve,
- informim për aktivitetin e Kuvendit dhe të Ekzekutivit nga shërbimi përkatës i këtij Sektori,
- koordinim të punëve në mes të organeve të Komunës: Kuvendit, Këshillit të Drejtorëve, komiteteve të Kuvendit dhe komisioneve të tjera etj.

c. Sektori i bashkësisë lokale

Gjatë periudhës raportuese, ky sektor ka organizuar bashkëpunimin më të mirë të komunës dhe qytetarëve të bashkësive lokale në identifikimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme kryesisht nga lëmi i infrastrukturës. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë organizuar tubime me qytetarë në disa bashkësi lokale lidhur me nevojat e tyre si dhe tubime me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për projekte kapitale për vitin 2011. Zyrat e bashkësive lokale kanë kryer shërbime administrative të ndryshme, ku sipas kërkesave të palëve janë lëshuar gjithsej 28,079 vërtetime për rregullimin e dokumentacionit personal, të drejtave në asistencë sociale, të drejtave të qytetarëve që përkohësisht jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme etj.

d. Sektori teknik

Puna e këtij sektori ka të bëjë me sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të komunës dhe objektet e bashkësive lokale. Është bërë mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe rrjetit telefonik brenda objektit të komunës është bërë ngjyrosja dhe rregullimi i zyrave brenda objekteve të komunës. Është bërë mbikëqyrja e përdorimit të automjeteve të komunës. Gjatë vitit 2010, nga gjithsejtë 45 automjete, për kryerjen e punëve zyrtare janë shënuar gjithsejtë 466,349 km të kaluara (gjatë vitit 2009 janë shënuar 422,233 km të kaluara që është për 10% më shumë). Sa i përket shpenzimet të derivateve, gjatë vitit 2010 nga automjetet e komunës janë harxhuar 63,031 litra derivate (gjatë vitit 2009 janë harxhuar 57,445 litra derivate që është për 9.7% më shumë). Rritja e shpenzimeve për derivate ka ardhur kryesisht si rezultat i shtimit të vëllimit të punëve siç është në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim ku është shtuar sektori i pylltarisë (si kompetencë shtesë që i është bartur Komunës së Prishtinës), në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ku është shtuar sektori i mirëqenies sociale etj.

e. Sektori i gjendjes civile

Gjatë periudhës raportuese në kuadër të këtij sektori janë realizuar këto pune:

- janë lëshuar certifikatat e lindjes 13,9670 (3,375 më shumë se vitin 2009),
- certifikatat e martesës 19,129 (270 më pak se në vitin 2009),
- certifikatat e vdekjes 6,363 (2112 më shumë se në vitin 2009),
- certifikatat e vendbanimit 615 (428 më shumë se në vitin 2009),
- certifikatat e shtetësisë 56,655 (44,017 më shumë se në vitin 2009),
- certifikatat e statusit martesor 5,078 (89 më pak se në vitin 2009),
- certifikatat jete (certifikatë që personi është i gjallë) 828,
- certifikatat e bashkësisë familjare 7,398,
- deklaratat me dy dëshmitar 239,
- vërtetim i fotokopjeve 66,101,
- certifikata për foshnje të porsalindura 10,670,
- certifikata martese 1,243.

Regjistrimet e lindjeve, martesave dhe vdekjeve që ndodhën jashtë Kosovës

- Regjistrimet speciale në LAL3115
- Regjistrimet speciale në LAM484
- Regjistrimet speciale në LAV71

f. Zyra pritëse

Përmes Zyrës pritëse nëpërmes intranetit janë pranuar 34,853 lëndë të prezantuara në pasqyrën si në vijim. Nga këto lëndë, vetëm 1,049 ose 3% kanë mbetur të pakryera dhe janë bartur në vitin 2011. Kotë janë kryesisht lëndë që kanë arritur në ditët e fundit të vitit 2010 dhe të cilat nuk kanë mundur të shqyrtohen.

Lëndët e pranuar nga zyra pritëse sipas drejtorive

Nr.	DREJTORITË	Pranuara	Miratuara	Refuzuar	Të hedhura poshtë	Pezulluar	Pakryera
1	Drejtoria e Administratës	2,119	2,016	12	8	5	78
2	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	1,204	664	53	-	460	27
3	Drejtoria e Arsimit	842	515	145	-	168	14
4	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	3,784	2,738	298	-	508	240
5	Drejtoria për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit	1,589	1,133	25	-	222	209
6	Drejtoria e Infrastrukturës Lokale	446	83	-	-	354	9
7	Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim	923	417	5	-	455	46
8	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	425	292	82	-	27	24
9	Drejtoria e Inspektionit	2,949	2,857	5	-	31	56
10	Drejtoria për Financa dhe Pronë	15,509	15,009	174	38	55	233
11	Drejtoria e Kadastrit	5,052	4,891	4	-	44	113
	Gjithsejtë:	34,853	30,615	803	46	2,329	1,049

Po ashtu, janë edhe 17,941 lëndë të pranuar në Librat e Protokollit:

- Vërtetime mbajtës familje, dhe ndihmë juridike 842
- Libri i ekspedicionit në vend 3007
- Libri i dorëzimit të postës personalisht 1662
- Libri i faturave hyrëse 1343
- Libri i Protokollit (konkurse, D.Z, etj) 5306
- Libri i Protokollit (vërtetime për çështje sociale) ... 4856
- Libri i Shtetësisë 925

Gjatë vitit 2010, janë pranuar edhe 6,147 lëndë-kërkesa për legalizimin e objekteve pa leje të cilat janë në procedurë.

Në librin intern-katastri janë evidentuar edhe 37,248 lëndë (certifikata dhe kopje të planit).

Kështu, në total gjatë vitit 2010, janë pranuar 96,189 lëndë: përmes intranetit 34,853, përmes librit të protokollit 17,941, lëndë-kërkesa për legalizimin e objekteve pa leje 6,147 dhe lëndë në librin intern-katastri 37,248 lëndë.

a. Zyra për teknologji informatike

Duke u bazuar në fushëveprimtarinë e Zyrës për Teknologji Informatike, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe ofrimit të shërbimeve sa me cilësore, gjatë vitit 2010 zyra ka

kryer punët si në vijim. Nga MAPL, janë pranuar dy serverë të ri, është bërë instalimin, konfigurimin, montimin dhe lëshuarjen e tyre ne punë. Në njërin është instalua softueri i Intranetit të ri kurse në tjetrin softueri i Gjendjes Civile dhe janë marrë licencat e programeve për nevojat e komunës. Janë hapur llogaritë për e-mail zyrtarë për të gjithë drejtorët dhe punëtove tjerë të komunës, është bërë konfigurimi i outllok-un dhe ComAgent-in për komunikim online ndërmjet veti. Në bashkëpunim me MAP, MAPL është bërë instalimin, konfigurimin e softuerëve për Intranet, e-Pasurisë, Gjendjes Civile online dhe Sistemin Elektronik për Arkivimin e Dokumenteve. Është mirëmbajtur ueb faqja e re te komunës, dhe është freskuar me të dhëna të reja të nevojshme. Janë instaluar antena ne Zyra të Vendit, ku Z.V. Besi është kyçur në bazën e të dhënave të Gjendjes Civile dhe punon online. Ndërkaq është bërë kyçja e zyrës së Gjendjes Civile në QKUK, përmes rrjetit qeveritar në serverin kryesor të Gjendjes Civile në komunë, si dhe kyçja në rrjet qeveritar me VPN përmes PTK-së të Drejtorisë për Infrastrukturë Lokale, që do të thotë se tash e tutje kjo drejtori do ti shfrytëzojë të gjitha shërbimet si; internet, intranet, e-mail zyrtar etj.

Janë instaluar, konfiguruar dhe montuar 10 kompjuter (kompjuter të përdorur) në disa zyre të Bashkësive Lokale. Nga Banka Botërore, si donacion janë pranuar 7 kompjuter desktop, 1 llap-top, 1 projektor, 1 printer për rrjetë dhe 1 skaner (sender) për arkivimin e lëndëve. Është bërë instalimi dhe konfigurimi i 100 kompjuter të ri të blerë nga komuna. Është këqyr në rrjetin qeveritar kompjuterik ndërtesën e komunës në Arbëri dhe është kyç zyra e ofiçarisë në Ulpianë, ne rrjetin qeveritar përmes antenës.

5. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Në vitin 2010, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) veprimtarinë e vet e ka zhvilluar përmes sektorit të shëndetësisë dhe sektorit të mirëqenies sociale. DSHMS ka vazhduar me realizimin e projekteve të filluara në vitin 2009 dhe ka filluar dhe përfunduar procedurat dhe punët në lidhje me projektet e reja të planifikuara për vitin 2010.

Në Komunën e Prishtinës, në të gjitha institucionet shëndetësore punojnë 90 mjekë familjarë, 50 mjekë të praksës së përgjithshme dhe 294 infermiere. Ky numër është shumë i vogël në krahasim me nevojat e popullsisë së Komunës së Prishtinës. Sipas vlerësimit të numrit të popullsisë për mjek familjarë, Komuna e Prishtinës duhet të ketë 250 mjekë familjarë dhe 500 infermiere. Ky numër do të plotësonte nevojat për shërbime shëndetësore të nivelit primar dhe di t'i mundësonte komunës të plotësoi me staf qendrat e reja të mjekësisë familjare.

DSHMS i ka kryer këto punë:

- në vazhdimësi ka përcjellë ndërtimin e QMF në Mati I (ndërtimi i objektit ka përfunduar dhe për t'u funksionalizuar duhet të bëhen punët rreth rregullimit të oborrit dhe rrethojave, kyçja në rrymë dhe ujësjellës/kanalizim);
- kanë filluar dhe përfunduar punët në ndërtimin e objektit te Ambulancës në Sharban dhe kjo ambulance ka filluar të punoj me 01.12.2010;
- është bërë funksionalizimi i objektit për strehimin e familjeve të pa strehë në Fushën e Pajtit (është punuar në kryerjen e procedurave të nevojshme administrative për kyçje në rrymë, ujësjellës dhe kanalizim të objektit) dhe komisioni i formuar nga pesë anëtarë në nivel komunal, ka filluar punën në përzgjedhjen e kandidatëve, që në bazë të rregullorës së aprovuar nga Kuvendi Komunal, i plotësojnë kriteret për të fituar strehim në këtë objekt për banim social;
- është bërë rregullimi i oborrit dhe funksionalizimi i QMF në lagjën Arbëria;

- është bërë rregullimi i oborrit dhe funksionalizimi i QMF në lagjën Vreshta;
- është bërë rregullimi i oborrit dhe funksionalizimi i QMF në Hajvali;
- është bërë rregullimi i oborrit dhe së shpejti funksionalizimi i QMF në lagjen Velania;
- është bërë furnizimi me inventar shëndetësor i QMF-ve;
- është bërë furnizimi me aparaturë mjekësore i QMF-ve;
- është bërë furnizimi me pajisje mjekësore i të gjitha ordinancave të QMF-ve;
- është bërë furnizimi me dy autoambulanca për nevojat e ENSHM-së;
- është bërë furnizimi me tri autoambulanca për nevojat e QKMF-së;
- është bërë furnizimi me aparaturë laboratorike dhe material shpenzues;
- janë kryer renovimet në kuadër të QKMF;
- janë kryer renovimet e Qendrës për Punë Sociale ,”Bregu i Diellit” dhe është bërë funksionalizimi i QPS;

Nga kjo drejtori është formuar grupi punues për hartimin e tri statuteve: për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Entin e Ndhmës së Shpejtë (ENSHM) dhe Qendrën për Punë Sociale (QPS). Këto draft statute kanë kaluar në diskutim publik, janë aprovuar në Komitetin për Shëndetësi dhe Komitetin për Politikë dhe Financa. Gjithashtu në periudhën Maj-Korrik 2010, është bërë dezinfektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës në katër faza. Në muajin Tetor 2010 është kryer deratizimi vjeshtor i bodrumeve dhe i garazheve si dhe i kanalizimeve të Komunës së Prishtinës. Me kërkesë të DSHMS nga Drejtoria e Urbanizmit është bërë ndarja e parcelës për ndërtimin e dy objekteve: njëri për banim social si dhe i një objekti të ri për banim për invalidët e luftës, veteranët dhe familjet të dëshmorëve në Fushën e Pajtitit. Janë kryer procedurat e tenderimit dhe kanë filluar punimet në ndërtimin e objektit të invalidëve të luftës, veteranëve dhe familjeve të dëshmorëve. Për objektin tjetër për banim social do të ndahet buxheti në vitin 2012.

Gjatë vitit 2010 janë zhvilluar procedurat në lidhje me zgjedhjen e drejtorit të QKMF Prishtinë, drejtorit të Entit të Ndhmës së Shpejtë si dhe zgjedhja e kandidatëve për specializime në lëmitë e Kujdesit Parësor Shëndetësor nga QKMF Prishtinë. Janë mbajtur takime pune me drejtorët e QPS, QKMF dhe ENSH si dhe disa takime me OJQ të personave me aftësi të kufizuar. DSHMS ka marrë pjesë në organizimin e Ditës Botërore të Shëndetësisë nën mbështetjen e OBSH dhe të Habitatit si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të Urbanizmit. Nëpërmes DSHMS është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me “One to one children’s fund” dhe Komunës së Prishtinës në lidhje me projektin e “ofrimit të shërbimeve sociale fëmijëve me nevoja të veqanta dhe fëmijëve të braktisur e të neglizhuar”, projekt ky që mbështetet nga Komisioni Evropian.

Komuna e Prishtinës është përzgjedhur nga Qeveria e Luxemburgut si pilot qendër për realizimin e projektit “komputerizimit të sistemit të informimit shëndetësor”. Me mbështetjen dhe ndihmesën nga DSHMS-ja, ka filluar faza e dytë e realizimit të këtij projekti. DSHMS-ja ka nënshkruar me QKUK-në një memorandum mirëkuptimi në lidhje me shkatërrimin e mbeturinave mjekësore të cilat janë akumuluar me vite nëpër hapësirat e QMF-ve sepse nuk është bërë shkatërrimi i tyre. Përmes DSHMS është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Punës dhe Mireqenjes Sociale për hapjen e dy kuzhinave popullore për ofrimin e 300 shujtave për familjet që janë në varfëri të skajshme (projekt ky që do të zgjasë një vit) dhe në të cilën ka participuar financiarisht edhe Komuna e Prishtinës. Janë bërë disa takime me donatorë dhe sponsorë për gjetjen e një bashkëpunimi më të mirë për ndërtimin e një spitali të qytetit të Prishtinës, si e domosdoshme për ofrimin e shërbimeve të nivelit sekondar popullatës së komunës së

Prishtinës. Gjatë këtij viti nga DSHMS është bërë privatizimi i shërbimit të higjienës dhe sigurimit të objekteve të QKMF dhe të ENSHM.

Në QKMF gjatë këtij viti janë realizuar 1.650.357 shërbime mjekësore dhe këshillime që është për 14% më shumë se në vitin 2009. Prej këtyre, 768,267 janë vizita mjekësore, 427042 janë shërbime laboratorike, 24023 janë shërbime rentgenologjike dhe 450304 janë shërbime tjera shëndetësore. Në Entin e Ndihmës së Shpejtë (ENSHM) gjatë këtij viti janë realizuar 36,697 shërbime, nga të cilët 8,721 kanë qenë vizita në teren, 10,932 kanë qenë vizita në ENSHM, 1,329 kanë qenë transporte të pacientëve, 751 kirurgji e vogël dhe 158 reanimime.

Në DSHMS janë realizuar edhe këto aktivitete: mbështetur në rekomandimet e ekspertëve mjekësor të fushave përkatëse është dhënë pëlqimi për fillimin e procedurave ligjoretretman mjekësor jashtë vendit për 76 aplikantë. Janë shqyrtuar ankesat e dy qytetarëve (për shkak të mungesës së terapisë nga lista esenciale e barërave në QMF).

Në sektorin e mirëqenies sociale janë realizuar këto aktivitete:

- Janë lejuar subvencionet në vlerë prej 93,605 euro, .
- Janë pranuar dhe sistemuar më se 1,400 kërkesa për ndihmë emergjente .
- Janë lejuar më se 890 kërkesa për ndihmë emergjente, ndërsa për shkak të mungesës së mjeteve janë refuzuar 450 kërkesa dhe në procedurë janë rreth 70 lëndë.
- Janë miratuar 9 kërkesa për përkrahje financiare të OJQ-ve.
- Është bërë monitorimi dhe është dhënë ndihmesa QPS-ve gjatë përzgjedhjes së familjeve për asistencë sociale (rreth 3,000 familje në Komunën e Prishtinës janë në asistencë sociale).

Janë pranuar gjithsej 45 lëndë për strehim si dhe 8 lëndë për renovimin-adaptimin e shtëpive të djegura në territorin e komunës së Prishtinës. Janë refuzuar të gjitha lëndët për strehim, në mungesë të objektit për banim social dhe janë udhëzuar që të konkurrojnë pas ndërtimit të objektit për banim social. Lëndët për renovimin e shtëpive të djegura janë refuzuar për shkak të mungesës së një fondi buxhetor për këto raste.

Në këtë drejtori janë paraqitur 83 kërkesa të invalidëve të luftës për realizimin e të drejtave të tyre sipas Ligjit mbi familjet e dëshmorëve, invalidëve personal, viktimave civile të luftës në Kosovë. Janë lëshuar 65 vërtetime për invalidët e luftës dhe viktimat civile të luftës. Gjatë kësaj periudhe kohore janë pranuar gjithsej 12 lëndë nga QKMF në Prishtinë që tu sigurohen të drejtat e punëtorëve me rastin e pensionimit për shkak të moshës, nga 12 lëndët e pranuar dy lëndë janë zgjidhur pozitivisht, dhjetë lëndë (që kanë të bëjnë me vitet e mëparshme) udhëzohen që të drejtën e tyre ta realizojnë përmes gjykatës. DSHMS ka marrë pjesë në komisione të ndryshme (për regjistrimin e inventarit të QKMF-së dhe të QMF-ve, në komisionin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimi i shiut në Fushën e Pajtimit, si dhe në komisionin e përbashkët për përcjelljen e lypësve në Shqipëri).

Disa here janë vizituar familjet e strehuara përkohësisht në „Fushë të Pajtimit”. Në DSHMS gjatë kësaj periudhe janë realizuar mbi 80 takime individuale për probleme të ndryshme ku është diskutuar për zgjedhje më të mirë. DSHMS me aktivitetet e veta synon për sigurimin sa ma cilësor të kujdesit parësorë shëndetësor, për të gjithë banorët e Prishtinës, ruajtjen e shëndetit publik për të gjithë qytetarët e Prishtinës, sigurimin i mirëqenies sociale dhe përkujdesjen për personat e sëmurë, të pa strehë dhe me nevoja të veçanta si dhe shtimi i disiplinës në punë.

6. DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit, gjatë vitit 2010 ka punuar në realizimin e investimeve kapitale për ndërtimin dhe meremetimin e objekteve shkollore, objekteve sportive, trajtimi dhe ruajtja e objekteve shkollore, inventarit dhe pasurive të tjera, në krijimin e kushteve më të mira për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe monitorimin e procesit mësimor.

a. Të dhëna për arsimin në Komunën e Prishtinës

Drejtoria për Arsimit gjatë vitit 2010 ka realizuar punët dhe detyrat sipas dinamikës së planifikuar. Në nivelin parauniversitar, në Komunën e Prishtinës, edukimi dhe arsimimi i fëmijëve dhe nxënësve u zhvillua në 8 institucione parashkollore publike, 5 institucione parashkollore private, 40 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta publike dhe 23 paralele të ndara fizike, 5 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta private, 12 shkolla të mesme të larta publike dhe 5 shkolla të mesme të larta private. Në të gjitha këto institucione arsimore janë të përfshirë gjithsej 53,510 fëmijë dhe nxënës të organizuar në 2,152 paralele.

Në institucionet parashkollore publike, gjatë vitit 2010, kanë qenë të sistemuar 1,707 fëmijë të të gjitha grupmoshave ndërsa në ato private rreth 565 fëmijë. Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ultë publik mësimin e kanë ndjekur 35,506 nxënës të shpërndarë në 1,369 paralele (prej tyre 166 nxënës turq, 72 nxënës serb dhe 29 nxënës boshnjak). Në shkollat fillore private mësimin e ndoqën 1,355 nxënës. Nga këto të dhëna rezulton se mesatarja e nxënësve në paralele në këtë nivel ishte 27 sish. Po ashtu në shkollat e mesme të larta publike mësimin e ndoqën 13,434 nxënës (prej tyre 111 turq dhe 23 boshnjak) të sistemuar në 385 paralele, ndërsa numri mesatar i nxënësve në paralele ishte 39. Në shkollat e mesme të larta private mësimin e ndoqën 943 nxënës. Në të gjitha këto shkolla publike në të tri nivelet janë të punësuar 3,320 mësimdhënës dhe shërbyes të tjerë për mësim në të gjitha gjuhët, kurse në shkollat private 182.

Edhe në këtë vit shkollor institucionet publike të arsimit janë ballafaquar me mungesë të hapësirës së mjaftueshme shkollore, sidomos te ato të mesme të larta, sepse objektet të cilat i kemi filluar t'i ndërtojmë, ende nuk janë vu në funksion. Megjithatë, gjatë këtij viti janë inauguruar rreth 20,285 m² hapësirë shkollore, gjë që do të thotë se në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar gjendja është përmirësuar dukshëm në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta (pra nga 1.10 m² për kokë nxënësi të hapësirës mësimore sa ishte në vitin 2009, gjatë vitit 2010 është rritur në 1.50 m² të hapësirës mësimore, gjë që nënkupton eliminimin e ndërrimit të tretë në të tri nivelet).

b. Ngritja e infrastrukturës shkollore, sportive dhe furnizimet gjatë vitit 2010

Gjatë vitit 2010 janë lëshuar në punë objektet shkollore të filluara viteve të mëparshme, ka filluar ndërtimi i disa objekteve shkollore, anekseve, objekteve të sportit të cilat po ashtu janë inauguruar brenda këtij viti dhe ka filluar ndërtimi i disa objekteve të cilat nuk janë përfunduar, por vazhdojnë të ndërtohen gjatë vitit 2011. Me objektet e reja të cilat janë përfunduar gjatë këtij viti Komuna e Prishtinës e ka shtuar hapësirën shkollore për 20,285 m², duke llogaritur vetëm hapësirat e objekteve shkollore.

Inaugurimi i objekteve të bartura nga viti 2009:

- Objekti i “Shkollë së Gjelbërt”, (Komuna-USAID) në Çamëri;.....2196m2.

- Objekti i shkollës fillore “Andon Z. Çajupi”, në Bardhosh, (MASHT); 4400m²
- Objekti i Gjinnazit “Xhevdet Doda” (Komuna – MASHT);4200m²
- Salla e edukatës fizike në shkollën fillore “Faik Konica” 600m²
- Salla e edukatës fizike në shkollën fillore “Meto Bajraktari” 600m²
- Salla e edukatës fizike në shkollën fillore “Mitrush Kuteli”...600m²
- Salla e edukatës fizike në shkollën fillore “Hilmi Rakovica”...720m²
- Salla e edukatës fizike në shkollën fillore “Xhemail Mustafa”600m²
- Terreni sportiv në shkollën fillore “Rilindja”, Keqekollë.....1500m²
- Terreni sportiv në shkollën fillore “Isa Boletini”, Busisë.....1500m²
- Terreni sportiv në shkollën fillore “Teuta”, Grashticës.....1500m²

Projektet e financuara nga Komisioni Evropian:

- Renovimi i objektit të shkollës fillore “Ismail Qemali” në Prishtinë: renovim i kulmit, i ngrohjes qendrore, hidroinstalimet me solare, donacion nga Komisioni Evropian,
- Renovimi i objektit të ShMT “Gjin Gazulli” të Prishtinës: renovim i kulmit, i ngrohjes qendrore, hidroinstalimet me solare, fasadimm i objektit, donacion e Komisionit Evropian.

Inaugurimi i objekteve të filluara në vitin 2010:

- Objekti i shkollës fillore “Nëna Tereze” PNF në Teneshdoll,820m²
- Aneksi i shkollës fillore “Gjergj Fishta, në Prishtinë.....925m²
- Aneksi i shkollës fillore “Naim frashëri, në Prishtinë.....2115m²
- Aneksi i shkollës fillore “Faik Konica”, në Prishtinë.....586m²
- Aneksi i shkollës fillore “Hilmi Rakovica”, në Prishtinë.....1051m²
- Aneksi i shkollës fillore “Dardania”, në Prishtinë.....872m²

Projektet që kanë filluar këtë vit dhe të cilat vazhdojnë në vitin 2011:

- Objekti i ri i shkollës fillore në Hajvali..... 4952,2 m²
- Objekti i shkollës fillore në lagjen “Arbëria” të Prishtinës.....2305,93 m²
- Terreni sportiv në shkollën fillore në Siqevë.....1500m²
- Terreni sportiv në shkollën fillore në Suteskë.....1500m²
- Terreni sportiv në shkollën fillore “Nëna Tereze” në Vranidoll.....1500 m²
- Terreni sportiv në shkollën fillore “në Dabishevc.....1500m²
- Rrethoja e oborrit të shkollës fillore “Ditët e Minatorit” në Shashkoc
- Rrethoja e oborrit të shkollës fillore “F. Shiroka” në Slivovë
- Rrethoja e oborrit të shkollës fillore”Tefik Çanga” Koliq, PNF në Podaj
- Rregullimi i oborrit dhe rrethoja për shkollën fillore “H. Rakovica” në Prishtinës,
- Rregullimi i oborrit të shkollës fillore “Mitrush Kuteli” në Mat,
- Rrethoja e oborrit të shkollës fillore “Pavarësia” në Prishtinë.

Projektet që financohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave:

- Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shkollën fillore “N. Gafurri”, Prishtinë
- Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shkollën fillore “Xh. Ahmeti”, Prishtinë
- Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shkollën fillore “Pavarësia”, Prishtinë
- Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në SHME “Gjin Gazulli”, Prishtinë
- Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shk. fillore “Meto Bajraktari”, Prishtinë

Meremetimi dhe rikonstruimi i objekteve shkollore gjatë vitit 2010:

- Gëlqerosja e 24 objekteve shkollore
- Fasadimi i gjashtë objekteve shkollore
- Ndërrimi i dritareve në pesë objekte shkollore
- Rikonstruime në objektet e katër shkollave të mesme
- Rikonstruimi i kulmeve, dritareve dhe rregullimi i oborreve në tetë objekte të shkollave fillore:
- Pajisje e shkollave me kabinete, inventar, libra dhe pajisje tjera
- Instalime të reja dhe rikonstruime të ngrohjes qendrore
- Renovimi komplet i objektit të vjetër të shkollë fillore “Nazim Gafurri”, Prishtinë – me bashkëfinancim Komuna/USAID
- Renovimi i nyjeve sanitare të shkollës fillore “Zenel Hajdini”, Prishtinë - - me bashkëfinancim Komuna/USAID

Objektet shkollore që kanë filluar dhe janë në realizim e sipër, financim i MASHT-it:

- Objekti i shkollës së mesme në Kalabri (pranës shkollë bujqësore)5850m2
- Objekti i shkollës së mesme në lagjen Kalabria, (te Trafiku Urban),.....5850m2
- Objekti i shkollës së mesme në lagjen Çamëria,5850m2
- Objekti i shkollës për edukimin special, në lagjen Kalabria,4200m2

Realizimi i projekteve të furnizimit: Furnizimi me inventar shkollor, me kompjuterë dhe fotokopjues, furnizimi me material mësimor për IP-të, furnizimi me material didaktik për shkollat fillore dhe të mesme, furnizimi me rekuizita sportive, me material sanitary për të gjitha shkollat, furnizimi me lëndë djegëse, furnizimi i shkollave me gjenerator, transporti i nxënësve dhe i arsimtarëve, furnizimi me material riparues, elektrik dhe rekuizita didaktike, dezinfektimi dhe deratizimi i të gjitha objekteve të institucioneve parashkollore, trajnimet e punonjësve të arsimit, riparimet e nxemjeve qendrore dhe pajisjeve tjera, furnizimet me material administrativo-didaktik, furnizimi i nxënësve me tekste shkollore, etj.

c. Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor dhe aktivitete tjera

Vizitat në institucionet edukativo-arsimore: Gjatë kësaj periudhe zyrtarët arsimorë kanë realizuar 101 vizita informative, 22 vizita të përgjithshme, 31 vizita profesionale, 19 vizita speciale dhe 11 vizita kthyese. Zyrtarët e arsimit, gjatë realizimit të vizitave nëpër shkolla, kanë kontrolluar dokumentacionin pedagogjik, plan-programet mësimore, kanë monitoruar punën e mësimdhënësve sipas planit-mbështetur në kapacitetet e drejtorisë, I kanë kontrolluar objektet shkollore dhe funksionalitetin e tyre, kanë përcjellë shkallën e vijueshmërisë së nxënësve, mësimdhënësve dhe të punësuarëve tjerë nëpër shkolla, kanë përcjellë shkallën e funksionimit të organeve profesionale dhe administrative të institucioneve shkollore, shkallën e bashkëpunimit me prindër, me institucionet tjera dhe shoqërinë civile. Ky shërbim ka analizuar vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve në mësim sipas periodave mësimore. Janë bërë vlerësimet dhe janë dhënë propozim-masat për përmirësime eventuale, sipas nevojës.

Aktivitetet tjera: Janë organizuar Garat e Diturisë që tashmë janë gara tradicionale, pastaj garat e matematikentëve në kuadër të Olimpiadës së Matematikës, garat “Gjuhëtari i Ri” në nivel komunal dhe republikan si dhe varg garash sportive në disiplina të ndryshme sportive. Në kuadër të shkollave janë organizuar dhe mbajtur aktivitete të ndryshme të karakterit garues por edhe kulturor e sportiv. Po ashtu Drejtoria e Arsimit ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e testeve kombëtare, në kuadër të përgjegjësive që i takojnë, dhe ka bërë

administrimin e testit të klasave të pesta, testit të maturës si dhe testit të arritshmërisë për klasat e nënta (9-ta)

Drejtoria për Arsim ka pasur një bashkëpunim të suksesshëm dhe ka organizuar trajnime në bashkëpunim me MASHT-in dhe organizata tjera si:

- Qendra e Arsimit të Kosovës (KEC),
- Komisioni Evropian: trajnimi për Edukatë qytetare,
- Organizata CESES: trajnimi për Formim dhe zhvillim,
- Foundation Together Slovenia dhe Fondacioni Together Kosova: Qendra Rajonale për Mirëqenie Psikosociale të Fëmijëve,
- Klubi Kosovar për Energji dhe Mjedis /KKEM/: Zhvillimi dhe rritja e njohurive mbi çështjet e mjedisit dhe të burimeve të energjisë në mesin e të rinjve dhe të shoqërisë civile,
- GTZ: Trajnimi për udhëheqje të shkollës,
- SWISS-CONTACT: firmat ushtrimore,
- Word Learning: trajnimi i mësimdhënësve të gjuhës angleze,
- Banka Botërore: trajnimi për hartimin e planeve zhvillimore të shkollave dhe realizimi i projekteve përmes granteve shkollore.
- USAID- AED: Zbatimi i Kurrikulimit të ri

d. Shërbimi i administratës

Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, në Drejtori kanë arritur 842 lëndë, prej të cilave janë miratuar 515, janë refuzuar 145, janë pezulluar 168 lëndë, ndërsa 14 lëndë janë bartur në vitin 2011. Gjatë kësaj kohe janë shpallur konkurset për pranimin e kuadrove në shkolla në të tri nivelet, si dhe konkurset për emërimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve që iu ka skaduar kontrata . Është bërë përgatitja e konkursit për pranim të nxënësve në shkollat e mesme të larta i cili është shpallur nga Ministria e Arsimit, dhe konform konkursit është bërë pranimi i nxënësve në shkollat e mesme të larta.

e. Shërbimi i financave

Shërbimi i financave pranë Drejtorisë për Arsim ka realizuar objektivat dhe detyrat e punës sipas planit: sigurimin e shënimeve statistikore për përpilimin e buxhetit; përgatitjen e raportit të buxhetit për institucioneve parashkollore, shkolla fillore dhe të mesme; planifikimin dhe shpërndarja e buxhetit nëpër Institucione parashkollore, shkolla fillore dhe të mesme si dhe rishikimin e buxhetit; zotimin dhe shpenzimin i mjeteve financiare; përcjelljen e shpenzimeve dhe përgatitjen e raporteve të shpenzimeve kapitale; përgatitjen e tenderëve dhe përcjelljen në procedurat e prokurimit; pranimin dhe përpunimin i lëndëve për pagesë dhe procedimin i pagesave për investime kapitale, mallra dhe shërbime, furnizime dhe shpenzime tjera për institucionet e të tri niveleve të arsimit.

7. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Gjatë vitit 2010, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) ka realizuar objektivat në bazë të politikave programore dhe prioriteteve të caktuara. Në politikat programore janë caktuar prioritetet për investime kapitale bazuar në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe hulumtimet në teren. Gjithashtu, është parapare buxheti për shënimin e festave dhe ngjarjeve të mëdha kulturore komunale dhe shtetërore. Janë pranuar, shqyrtuar dhe proceduar kërkesat

për subvencionim të projekteve bazuar në planin programorë të DKRS-së. Drejtoria ka pranuar gjithsej 425 lëndë, prej të cilave janë miratuar 292, janë refuzuar 82, janë dhënë njoftime në 27 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 24.

a. Projektet kapitale 2010

Gjatë vitit 2010 janë realizuar këto projekte kapitale:

- **Ndërtimi i Bibliotekës së Qytetit Hivzi Sylejmani** – ka përfunduar faza e parë e punës në ndërtim sipas dinamikës së realizimit të projektit. Puna në projekt vazhdon në vitin 2011.
- **Ndriçimi dhe zërimi i Teatrit DODONA** – ka përfunduar në tërësi projekti për ndriçimin dhe zërimin.
- **Qendra rekreative e fëmijëve** – kanë përfunduar punimet në 13 shtëpiza.
- **Restaurimi Xhamia e Çarshisë** – është përpiluar projekti për restaurimin e objektit dhe në bazë të marrëveshjes për bashkëpunim mes Komunës së Prishtinës dhe MKRS-së mjetet janë alokuar në Institutin Shtetërorë për Monumente.
- **Hamami i qytetit** – ka përfunduar faza e dytë e punës. Për arsye të nevojës për ridestinim të objektit të Hamamit është tërheq nga tenderimi projekti për realizimin e fazës së tretë në kuadër të së cilës do të projektohet infrastruktura e brendshme e objektit. Puna në Hamamin e qytetit kryhet në bashkëpunim me Institutin shtetërorë për ruajtjen e monumenteve dhe Ministrin për kulturë, rini dhe sport.
- **Terrenet sportive** – është përfunduar terreni sportiv në oborrin e shkollës fillore “Isa Boletini” në Busi, si dhe terreni sportiv në lagjen Arbëria. Gjithashtu, është kompletuar projekti për realizimin terrenit sportiv në fushën e pajtimit. Punimet do të vazhdojnë edhe në vitin 2011.
- **Pajisja me tituj e Bibliotekës Hivzi Sylejmani** – është rritur fondi i libriave për 953 tituj, me 7629 ekzemplarë.

b. Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme kulturore

Në programin për shënimin e festave dhe ngjarjeve të mëdha kulturore komunale dhe shtetërore, kombëtare dhe ndërkombëtare, në vitin 2010 drejtoria ka realizuar dhe ka investuar në këto organizime festash:

- Dy vjetori i shpalljes së Pavarësisë
- Dita e Dëshmorëve të Prishtinës
- Dita e Evropës 2010
- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve
- Dita e Prishtinës ‘11 Qershor’
- Dita e pavarësisë së SHBA-ve
- Mbrëmjet verore
- Festivali Ndërkombëtar i Fëmijëve “YLBERI I PRISHTINËS”
- Dita e Flamurit 28 Nëntori
- Ndriçimi dhe zbukurimi i qytetit për festat e fund vitit
- Festa e vitit të ri
- Sportisti i vitit 2010 dhe Turneu memorial i shahut ‘Hyzri Talla’
- Muaji i Rinisë

Gjithashtu, drejtoria ka bashkëpunuar edhe me organizata të ndryshëm duke u ofruar ndihmë logjistike dhe organizative lidhur me këto ngjarje:

- Dita e mësuesit
- Dita Ndërkombëtare e Gruas
- Festivali i luleve "Pranvera në Prishtinë"
- Ditët e Bibliotekës
- Festa e muzikës
- Kampingjet në futboll - Prishtinë
- Dita ndërkombëtare e rinisë
- Seminari: Përgatitje mendore në sport dhe jetën e përditshme
- Seminari SPORT FOR ALL
- Festivali i automjeteve klasike
- 'OLDTIMER CLUB'

c. Projektet e përkrahura me subvencione

Gjatë vitit 2010, DKRS ka përkrahur 265 projekte të ndryshme:

- Në fushën e kulturës janë përkrahur 167 projekte:
 - Veprimtari botuese 57
 - Artet muzikore dhe skenike 64
 - Artet pamore 13
 - Teatrot dhe filmime 12
 - Sektori i gjinisë dhe AKFP 21
- Në fushën e rinisë dhe sportit janë përkrahur 98 projekte:
 - Klube sportive 73
 - Organizata rinore 25

Këto projekte janë përkrahur me subvencione në shumën prej 200,158 € Prej tyre, për projekte kulturore 156,728 € dhe në fushën e rinisë dhe sportit 106,570 €

d. Sektori për kulturë

Numri i projekteve kulturore të përkrahura në vitin 2010 është 167. Vlen të theksohet suksesi i veçantë në veprimtarinë botuese me mbështetjen e 57 tituj nga zhanret e ndryshme të krijimtarisë letrare. Artet pamore janë mbështetur me 13 ekspozita, 12 projekte teatrot dhe filmime, 26 festivale të ndryshme, 38 koncerte dhe 21 projekte që mbështetin sektorin e gjinisë dhe asamblesë komunale të fëmijëve.

e. Sektori për sport dhe rini

Numri total i projekteve sportive dhe rinore të përkrahura gjatë vitit 2010 është 98. Gjithsej projekte të sportit janë 73 të realizuara përmes klubeve sportive siç janë: 3 klube të hendbollit, 4 klube të volejbollit, 2 klube të basketbollit, 3 klube të Taekëando-së, 15 klube të karatesë, 2 klube të xhudos, 2 klube të notit, 7 klube të futbollit, 2 klube çiklistike, 2 aeroklube, 1 klub i skitarëve, 2 klube të Kickbox-it, 2 klube të atletikës, 4 klube të shenjëtarisë, 2 klube për ping pong, 2 klube të boksit, 3 klube të shahut dhe 15 klube të tjera. Sektori për rini ka realizuara gjithsej 25 projekte, e këto janë: 2 KVRL dhe Qendra rinore, debate dhe tryeza të rrumbullakëta me tema të ndryshme vetëdijësuese, 5 për promovimin e ligjit për rini dhe udhëzime administrative me pjesëmarrjen aktive të zyrtarëve në hartimin e tyre. Projektet tjera janë aktivitete rekreative rinore.

f. Institucionet vartëse të DKRS-së

Janë hartuar tre statutet e institucioneve kulturore: Teatri i qytetit të Dodona, Qendra kulturore e fëmijëve të Prishtinës dhe Biblioteka “Hivzi Sylejmani”.

Teatri i qytetit Dodona: Ky teatër ka filluar me ritmin e zakonshëm të punës duke i zhvilluar normalisht aktivitetet e veta. Në kuadër të teatrit të qytetit ‘Dodona’ funksionojnë dy skena: Teatri i kukullave dhe Skena e mbrëmjes. Gjatë vitit 2010 Teatri i kukullave ka pasur dy premiera. Skena e mbrëmjes ka realizuar 4 shfaqje premierë. Teatrin e kanë vizituar rreth 18 mijë shikues gjatë vitit 2010. Një program është realizuar në gjuhën turke. Shfaqje të ndryshme të teatrit të qytetit kanë qenë prezent nëpër qytete të ndryshme të Kosovës si dhe në disa festivale kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim të promovimit të punës dhe kulturës tonë.

Biblioteka ‘Hivzi Sylejmani’: Përveç veprimtarisë bibliotekare si pasurimi me tituj të rinj, klasifikimi, katalogimi, inventarizimi i librit dhe puna me lexues, në bibliotekën ‘Hivzi Sylejmani’ u zhvilluan aktivitetet e shumta kulturore që kanë të bëjë me librin dhe bibliotekën. Në kuadër të Javës së bibliotekës me 16 prill u organizuan disa aktivitetet: u bë hapja zyrtare e UEB - faqes së bibliotekës, një dritare për lexuesit e bibliotekës dhe për banorët e kryeqytetit, ku mund të gjenden të gjitha informacionet për veprimtarinë dhe aktivitetet e bibliotekës. Me 30.7.2010 u vendos gur themeli i objektit të ri të Bibliotekës së Qytetit të Prishtinës. Në shkollën ‘Meto Bajraktari’ u rihap biblioteka e shkollës mbështetur nga Biblioteka “Hivzi Sylejmani”. Pas një ndërprerje prej tri vjetësh, është rihapur biblioteka e fshatit Koliq, degë e bibliotekës ‘Hivzi Sulejmani’ e cila do të jetë në shërbim të nxënësve të shkollës fillore ‘Tefik Çanga’ dhe të gjithë banorëve të këtij fshati. Fondi i kësaj biblioteke është i pasur me literaturë nga të gjitha lëmit, posaçërisht me liktyrë shkollore. DKRS edhe këtë vit ka përkrahur projektin për pasurimin e bibliotekës me 730 tituj dhe 6565 ekzemplarë. Nga Panairi i 12-të i Librit në Prishtinë, biblioteka u pasurua me tituj të rinj nga të hyrat vetanake. Në këtë panair u blenë: 119 tituj me 529 ekzemplarë. Biblioteka mori pjesë në Panairin e librit ‘Tirana 2010’, ngjarje kjo më e rëndësishme kulturore e librit në trojet shqiptare. Në këtë panair biblioteka u pasurua me 104 tituj të rinj të librave, gjegjësisht 535 ekzemplarë. Vlen të theksohet se me pasurimin e titujve të ri vërehet rritja e numrit të anëtarëve. Në vitin 2010 janë anëtarësuar 5090 lexues të rinj, kurse gjatë tërë vitit janë lexuar 89,945 libra.

Qendra kulturore e fëmijëve të Prishtinës: Në vitin 2010 në qendrën kulturore të fëmijëve kane gravituar afër 500 fëmijë në aktivitetet të ndryshme. Në kuadër të qendrës funksionojnë seksioni i valleve, dramës, muzikës, teatrit, pikturës, sportit dhe grupi të ambasadorëve të vegjël. Gjatë vitit 2010 në Sallën e Kuqe janë realizuar 12 koncerte me programe për fëmijë. Qendra ka marrë pjesë në të gjitha ngjarjet e rëndësishme kulturore historike, ka vizituar ambasadat e shteteve të ndryshme që punojnë dhe veprojnë në Prishtinë, ka përgatitur recitale dhe fragmente teatrore për fëmijë. Ka marrë pjesë në disa festivale vendore dhe ndërkombëtare, si në Turqi dhe Shqipëri. Ka bërë organizimin dhe realizimin e Festivalit Ndërkombëtar të Fëmijëve “Ylberi i Prishtinës” dhe aktivitetet tjera për festat e fund vitit gjithmonë në mbështetje të DKRS-së.

Arkivi Komunal: Në fillimin e vitit është bërë konsolidimi i Arkivit me stafin punës dhe inventarë elementarë, si dhe futjen në funksion të të gjitha pajisjeve të cilat i posedon Arkivi për krijimin e kushteve normale për të vazhduar veprimtarinë e punës në Arkiv. Me datën 25 Mars 2010 është bërë bartja e një pjese të lëndës arkivore e cila ishte e vendosur

përkohësisht në Arkivin e Kosovës dhe u bartë në Ndërtesën e Re të Arkivit Komunal- të Prishtinës. Është bërë montimi i një pjesë të rafteve dhe vendosja e kutive arkivore sipas njësive organizative të Fondit të Kuvendit Komunal- Prishtinë (vitet 1948- 1995). Nga 12.04.2010 ka filluar pranimin e kërkesave nga palët për dokumentacion të cilin e disponon Arkivi. Ka pasur rreth 385 kërkesa të palëve deri në fund të vitit 2010. Prej tre mujorshit të dytë të vitit 2010 deri në fund të vitit është klasifikuar në njësi organizative Fondi i Kuvendit Komunal - Prishtinë për vitet 1979-1999. Janë hulumtuar dhe konstatuar shumë dëshmi për institucionet e ndryshme me dokumentacion teknik dhe juridik. Është hartuar udhërrëfyesit (skedarët) për fondin e Kuvendit Komunal-Prishtinë për arsye se skedarët origjinal kanë ngelur në Arkivin Ndërkomunal. Janë hartuar 14 udhërrëfyes (skedarë) A-ZH dhe lista të brendshme për 2357 kuti arkivore. Është bërë ndërrimi i kutive të dëmtuara me kutia të reja. Janë vendosur tiketat e dëmtuara në kutia të reja. Është bërë hospitimi i disa regjistraturave që i përkasin Arkivit Komunal të Prishtinës.

8. DREJTORIA E FINANCAVE DHE PRONËS

a. Të hyrat vetanake

Të hyrat buxhetore për vitin 2010 të planifikuara në nivel prej 19,555,125 € janë realizuar në shkallë prej 96.97% apo 18,962,276.07€ (shih tabelën në vijim). Shkalla e realizimit të të hyrave vetjake në vitin 2010 është më e lart në krahasim me vitin 2009 për 3%. Në krahasim me vitin 2009, gjatë këtij viti janë rritur sidomos të hyrat nga shfrytëzimi i sipërfaqeve publike për 23%, licencat në biznes për 26%, të hyrat në arsim për 31%, të hyrat në shëndetësi për 10% etj.

Gjatë vitit 2010 është bërë ndarja e zonës kadastrale me Komunën e Graçanicës, sipas kufijve administrative, dhe kjo ka ndikuar në zvogëlimin e të hyrave nga tatimi në pronë. Në muajin shtator 2010, me vendim të Kuvendit është bërë korrigjimi i ngarkesës tatimore nga tatimi në pronë sipas vijës ndarëse me Komunën e Graçanicës duke hequr nga regjistri i ngarkesës tatimore 2,114 objekte. Nga ky proces, është bërë transferi i lëndëve dhe mjeteve nga të hyrat vetjake (tatimi në pronë dhe lejet urbanistike) nga Prishtina në Graçanicë.

Sipas afatit ligjor, shpërndarja e faturave tatimore është bërë me dy muaj vonesë nga ana e PTK-së gjë që ka ndikuar në uljen e inkasimit të tatimit në pronë. Ekzistojnë ende borxhe të painkasuara lidhur me tatimin në pronë të ndërmarrjeve të privatizuara dhe në proces të privatizimit. Të dhënat agregate për të hyrat komunale janë prezentuar në tabelën e mëposhtme.

Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetjake për 2010

	Përshkrimi	Planifikimi	Realizimi	%
1	Taksa për leje ndërtimi	10,089,764	8,564,366	85%
2	Tatimi në pronën e paluajtshme	4,220,361	3,776,197	89%
3	Taksa për leje pune	700,000	745,461	106%
4	Taksa për shfrytëzimi i sipërfaqeve publike	600,000	969,170	162%
5	Taksa nga kadastru dhe gjeodezia	600,000	417,025	70%
6	Taksa për transakcion në pronë	730,000	677,100	93%
7	Të hyra nga inspekcioni	145,000	115,001	79%
8	Taksa për certifikata dhe dokumente zyrtare	160,000	335,464	210%
9	Taksa për automjete motorike	300,000	400,092	133%

10	Taksa për shërbime arsimore	800,000	1,129,040	141%
11	Taksa për shërbime shëndetësore	200,000	193,901	97%
12	Gjobat në trafik	900,000	995,580	111%
13	Participime / Donacione	50,000	215,000	430%
14	Të hyra tjera	60,000	89,347	158%
15	Agjensioni i pyejeve	-	6,017	-
16	Gjobat nga gjykatat	-	333,516	-
Gjithsej		19,555,125	18,962,277	97%

Niveli prej 85% i arkëtimit të të hyrave nga lejet e ndërtimit ka ardhur si rezultat i rritjes së parashikimit të të hyrave nga lejet ndërtimore për 2 mil € në shtator 2010. Kjo shumë prej 2 mil € është hequr nga parashikimi i të hyrave për 2010 nga tatimi në pronë për shkak të objekteve që tani ndodhen në Komunën e Graçanicës.

b. Shpenzimi i buxhetit

Gjatë vitit 2010, Komuna e Prishtinës ka pasur të buxhetuara mjete në vlerë prej 52,271,152 € (nga granti 32,827,996 € dhe nga të hyrat vetjake 19,555,125 €). Gjatë vitit 2010, janë shpenzuar 39,769,590 € apo 76.08% e buxhetit, kurse pjesa tjetër e mbetur e buxhetit u takon projekteve të kontraktuara, të pashpenzuara dh të bartura në vitin 2011. Pas decentralizimit të funksionit të shpenzimeve tek organizata buxhetore, për nivel lokal, komuna është bërë plotësisht përgjegjëse për procesimin e shpenzimeve, me kompetenca për kontrollim të dokumenteve, aprovim dhe pagesa.

Në tabelën në vijim, paraqitet planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2010. Niveli i tillë i shpenzimit të buxhetit ka ardhur si rezultat i disa faktorëve. Së pari, janë paraqitur pengesa në realizimin e disa projekteve për shkak të problemeve pronësore, siç është rasti tek Rruga e Shkupit. Pastaj, investimet në rrjetin e ujësjellësit nga KUR Prishtina ka pamundësuar investimet në shumë rrugë në qytet. Në vonesën e implementimit të disa projekteve kanë ndikuar edhe kushtet atmosferike sidomos tek asfaltimet ku temperaturat duhet të jenë optimale për tu kryer asfaltimi.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për 2010

Nr.	Përshkrimi	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit
1	Paga dhe Mëditje	16,026,246.00	16,017,196.82	99.94
2	Mallra dhe Shërbime	4,606,633.00	4,078,610.38	88.53
3	Shpenzime Komunale	2,115,714.00	2,100,659.52	99.28
4	Subvencione dhe Transfere	546,142.00	538,651.29	98.57
5	Investime Kapitale	28,976,417.00	17,034,472.75	58.78
Gjithsej		52,271,152.00	39,769,590.76	76.08

Shpenzimet buxhetore të paraqitura në tabelën në vijim të ndara sipas programeve në (administratë të përgjithshme, shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe arsim), janë mjete nga granti dhe të hyrat vetjake. Shkalla e realizimit të buxhetit në administratën komunale në nivel të përgjithshëm është 61.26%. Në shëndetësi dhe mirëqenie sociale, nga buxheti i planifikuar shpenzimet janë realizuar 87.65%. Në arsim, shkalla e realizimit të tyre është 96.54%. Orientimi kryesor i këtyre programeve ka qenë në investimeve kapitale si në infrastrukturë rrugore, shëndetësi, arsim, kulturë etj.

Janë tre arsye themelore, të cilat kanë ndikuar në mosshpenzimin e plotë të fondeve të ndara për shpenzime kapitale në vitin 2010:

- punët të cilat janë zhvilluar në qytet në rr. Bill Clinton, në rrethrotullimin në hyrje të qytetit nga Peja dhe punët në instalimin e gypit kryesor të ujit nga Arbëria në Velani kanë ndikuar që të hiqet dorë nga disa investime në qytet për të mos bllokuar qarkullimin;
- problemet pronësore të shfaqura në disa rrugë, siç janë ato në rrugën e Shkupit, në trasenë e kolektorit në Kalabri;
- kapacitetet e pamjaftueshme të zyrës së prokurimit për të përballuar të gjitha lëndët e prokurimit në fillim të vitit.

Shpenzimet buxhetore sipas programeve

Përshkrimi	Administrata e Përgjithshme	Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Arsim
Paga dhe Mëditje	97.73%	99.98%	99.95%
Mallra dhe Shërbime	73.16%	81.31%	80.56%
Shpenzime Komunale	99.94%	99.49%	98.65%
Subvencione dhe Transfere	98.91%	94.99%	-
Investime Kapitale	54.54%	61.42%	93.48%
Gjithsej	61.26%	87.65%	96.54%

c. Sektori për buxhet dhe financa

Ky sektor në periudhën raportuese, në pajtim me ligjet bazë dhe të ligjit për vetëqeverisje lokale, ka zhvilluar aktivitetet e më poshtme:

- Përgatitja e raporteve periodike financiare,
- Përgatitja e Pasqyrës Financiare për vitin 2010,
- Përgatitja e listës së projekteve me ridestitim dhe për bartje të buxhetit në vitin 2010,
- Nënshkrimi i të gjithave pagesave-transaksioneve financiare,
- Zotimi i mjeteve dhe plotësimi i formularëve në sistemin Free Balanc,
- Pranimi dhe regjistrimi i faturave (obligim-pagesë) nr.01-2890,
- Kontimi i të gjitha urdhëresave në programin softverik; nr.01-1316,
- Regjistrimi i të hyrave nga inkasimi ditor (arka e taksave nr.1-233),
- Regjistrimi i të hyrave vetjake në sistemin Free Balanc dhe në programin softverik,
- Barazimet mujore me Departamentin e Thesarit-MEF,
- Pranimi dorëzimi i parasë së imët në arkë dhe regjistrimi në ditarin e arkës,
- Pagesa e faturave të imëta me para të gatshme, nr.01-206,
- Kontimi dhe evidentimi i listës së të ardhurave personale nr.01-13,
- Plotësimi dhe ndryshimi i llogaritjes së të ardhurave personale-dërgimi në MSHP,
- Alokimi i të hyrave dhe balancimi i tyre me shpenzimet,
- Përgatitja e procesit të rrjedhës së parasë,
- Përgatitja e propozim buxhetit për vitin 2011-2013 dhe
- Punë të tjera sipas kërkesës së menaxhmentit.

d. Sektori i tatimit në pronë

Gjatë periudhës raportuese, zyra për operimin e të dhënave për tatimpaguesit në territorin e Komunës së Prishtinës, ka zhvilluar këtë aktivitet:

- Matjen dhe regjistrimin e objekteve të pa regjistruara në 200 raste,
- Dhënien e vërejtjeve për tatimpaguesit me obligime si detyrë e përhershme,
- Barazimin e pagesave bankare të tatimpaguesve me bazën e të dhënave,
- Korrigjimin e zonave, adresës, emërtimeve për 400 raste,
- Nxjerrjen e vendimit sipas ankesave të tatimpaguesve për 910 raste,
- Harmonizimin e të dhënave me departamentin e tatimit në pronë në kuadër të MEF-it, për vlerësimin e pronës së paluajtshme, tatimit në pronë, shkëmbit të përvojave, pjesëmarrja aktive në kolegjiunin e drejtorëve të drejtorive për financa dhe ekonomi, në kuadër të asociacionit të komunave të Kosovës,
- Nxjerrjen e vendimit të pagesës së transaksionit në pronë.

e. Sektori i pronës

Gjatë vitit 2010, sektori i pronës është vendosur në kuadër të kësaj drejtorie pas riorganizimit të drejtorive komunale pas zgjedhjeve të vitit 2009. Në vitin 2010, në sektorin e pronës janë paraqitur 485 lëndë si: kërkesa për lirim të pronës publike nga uzurpimi arbitrar, kërkesa për realizimin e marrëveshjeve për këmbim të tokës, kërkesa për fillimin e procedurave të shpronësimit dhe kërkesa të natyrave të tjera të cilat janë shqyrtuar sipas afateve të parapara me ligj etj. Disa kërkesa janë dërguar edhe nga Drejtoria Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e objekteve shkollore arsimit të ulte dhe të mesëm, të objekteve shëndetësore, dhe shërbimit të zjarrfiskëve me ç'rast Sektori i Pronës në bashkëpunim me Drejtorin e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka siguruar lokacionet përkatëse për ndërtimin e këtyre objekteve.

Një numër i kërkesave ka arritur edhe nga Gjykata Komunale dhe përfaqësuesi juridik i Komunës. Natyra e kërkesave ka qenë njoftimi për fazën e zhvillimit të procedurës, për verifikimin e origjinalitetit të dokumenteve të ndryshme si dhe format e procedurave të zhvilluara në nxjerrjen e këtyre dokumenteve. Një numër i konsiderueshëm i kërkesave ka arritur edhe për kompensimin e paluajtshmërive të pronarëve privat të cilat parcela sipas planeve urbanistike janë paraparë për hapësira publike si që janë: rrugë, hapësira gjelbëruese, sheshe etj. Gjithashtu janë lidhur marrëveshje për këmbimin e pronës komunale me prona private si: Marrëveshja për këmbimin e pronës Komunale e lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe personit fizike për ndërtimin e shkollës në Matiqan, pastaj marrëveshja për këmbimin e pronës komunale me pronën e Ministrisë së Drejtësisë e lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Drejtësisë më qëllim të ndërtimit të Pallatit të drejtësisë.

Sektori i Pronës gjithashtu ka realizuar lidhjen e marrëveshjeve me pronarët e lokaleve në Bulevardin “Bill Klinton”, që kanë qenë pjesë e realizimit të projektit të ndërtimit të rrugës në Bulevardin “Bill Klinton”. Është nënshkruar marrëveshja me kompaninë “Dukagjini” për ndërtimin e nënkalimit të rrethi në rrugën “Bill Klinton”. Gjithashtu është arrit marrëveshja me personin fizikë për ndërtimin e rrugës “B” në lagjen e spitalit. Një pjesë e konsiderueshme e kërkesave kanë mbetur pa u realizuar në ato raste ku është paraparë që të merren pronat private, të cilat ngastra janë paraparë sipas planit urbanistik për hapësira publike në mungesë të të dhënave kadastrale (manualet). Ndërsa për ngastrat kadastrale për të cilat kjo drejtori posedon të dhëna të mjaftueshme është duke u zhvilluar procedura administrative për shpronësimin e pronave private në bazë të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Sektori i Pronës është duke zhvilluar procedurë administrative sipas kërkesës së Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale për realizimin e projektit në lagjen

“Kalabria” në mbulimin e kolektorit atmosferik mbi lumin “Prishtina”, ku për realizimin e këtij projekti. Kërkesat për të cilat nuk kemi mundur që të zhvillojmë procedura të deekspropriimit kanë qenë kërkesat e pronarëve të cilat parcela kanë qenë të ekspropriuar në periudhat e paraluftës ku personat kërkojnë që t’u kthehen këto toka.

9. DREJTORIA E EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

a. Sektori i Ekonomisë

Gjatë vitit 2010, sektori i ekonomisë ka trajtuar 3,784 lëndë, prej të cilave leje pune të lëshuara kanë qenë 3,620 (në vitin 2009 janë lëshuar 2,431 leje pune që është një rritje prej 49%). Lëndët e tjera kanë qenë vërtetime dhe njoftime. Përveç këtyre lëndëve, në këtë drejtori janë trajtuar edhe 3,776 lëndë të natyrave të ndryshme siç është rasti tek inspektimet në terren, lëndë nga sektori i bujqësisë dhe veterinarisë, pylltarisë dhe lëndë që kanë ardhur në këtë drejtori por janë përcjell tek organet e tjera të komunës.

Realizimi i të hyrave nga biznesi për këtë periudhë kohore është: 745.461,00€ që në krahasim me vitin paraprak është për 27% me shumë. Përqindja e realizimit të të hyrave të planifikuara ka qenë 6.49% më e lartë se planifikimi. Vlen të potencohet se zbritja e taksave për biznese ka dhënë rezultatet e veta. Aksioni i ndërmarrë nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim i mbështetur edhe nga stafi i drejtorive tjera për vizitën e bizneseve lidhur me pajisjen me leje pune, ka dhënë rezultatet e veta. Në sektorin e transportit të udhëtarëve me auto-taksi janë bërë ndryshime cilësore dhe vizuale duke zbatuar Rregulloren mbi këtë lloj transporti ku qytetarëve u është ofruar siguri si dhe transparencë lidhur me shfrytëzimin e këtij lloj shërbimi si dhe vendosjen e shenjave identifikuese mbi auto-veturat.

Në periudhën raportuese është realizuar projekti “Trajnimi i të rinjve në punë” ku 26 të rinj të pa punë janë trajnuar direkt në punë dhe për këtë janë kompensuar nga 130 € në muaj. Projekti ka zgjat 5 muaj. Pastaj në bashkëpunim me MTI-in gjegjësisht Agjencionin për mbështetjen e bizneseve janë përzgjedh 5 biznes plane më të mira, ku vendi i parë është stimuluar me 1.000€ nga Komuna e Prishtinës. Gjatë periudhës raportuese është bërë përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për projektet për aplikim në Komisionin Evropian për mbështetjen financiare të tyre. Kështu komuna e Prishtinës është përfituese e projektit “One Stop Shop”, projekt ky që do të jetë shumë i rëndësishëm, sidomos për komunitetin e biznesit.

b. Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural

Gjatë vitit 2010, ky sektor ka përcjell punët në lëmin e bujqësisë si: procesi i mbjelljeve pranverore, procesi të korrje-shirjeve, këshillime profesionale të fermerëve, procesi i mbjelljeve vjeshtore, ndërsa në lëmin e pylltarisë aktivitet kryesor ka qenë ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve (prerje ilegale, erozioni etj.), pastaj damkosja (në stivë) e masës drusore (e lejuar për shfrytëzim) si dhe përcjellja e pyllëzimit. Projektet dhe aktivitetet e realizuara në shërbimin e bujqësisë janë dhënë në tabelën në vijim. Komuna ka mbështetur këto projekte me 159,969 €

Projektet në sektorin e bujqësisë

	Vlera / €
1. Realizimi i mbjelljeve pranverore	---
2. Subvencionimi i fermerëve për mbjelljet pranverore	42.624,03
3. Furnizimi me serra dhe fidanë	39.359,00
4. Vaksinimi i gjedheve dhe qenve	9.800,00
5. Eliminimi i qenve endacak	18.192,00
6. Këshillime profesionale të fermerëve	---
7. Procesi i korrje-shirjeve	---
8. Realizimi i mbjelljeve vjeshtore	---
9. Subvencionimi i fermerëve për mbjellje vjeshtore	49.994,40
Gjithsej:	159.969,43

Realizimi i mbjelljeve pranverore: Bazuar në programin e të mbjellave pranverore për vitin 2010 në Komunën e Prishtinës janë mbjellë gjithsej 1.385 ha me kultura pranverore. Sipërfaqet e mbjella me kultura pranverore/ha.

Struktura e të mbjellave pranverore

Nr.	Kultura	Sipërfaqe/ha
1.	Tërshërë	65
2.	Misër	890
3.	Bimë foragjere	20
4.	Patate	340
5.	Perime	41
6.	Fasule si monokulturë	14
7.	Elb pranveror	15
	Gjithsej	1.385

Me qëllim të përkrahjes së fermerëve për mbjellje pranverore si dhe stimulimin e fermerëve për rritjen e sipërfaqeve me kultura pranverore Komuna e Prishtinës ka bërë subvencionimin e disa kategorive të fermerëve me disa projekte si:

- **Subvencionimi i fermerëve për mbjelljet pranverore:** Në projektin e subvencionimit të fermerëve për mbjelljen e nga 1-2 ha me misër kanë përfituar gjithsej 164 fermerë, ndërsa për mbjelljen e sipërfaqeve me patate janë përkrahur 58 fermerë. Vlera e përgjithshme e këtij subvencionimi ka qenë 42.624,03€.
- **Furnizimi me serra dhe fidanë:** Me këtë projekt janë përkrahur 250 fermerë me nga një serrë në sipërfaqe prej 54m², si dhe me nga 100 fidanë (70 spec dhe 30 domate).
- **Vaksinimi i gjedheve dhe qenve:** Me qëllim të parandalimit të paraqitjes së sëmundjeve infektive është bërë vaksinimi i gjithsej 3.631 gjedheve dhe 380 qenve.
- **Eliminimi i qenve endacak:** Eliminimi i qenve endacak është realizuar gjatë muajve Janar, Shkurt, Mars dhe Prill. Gjatë këtij aksioni janë eliminuar gjithsej 1.137 qen endacak dhe është përfshirë tërë qyteti dhe zonat rurale. Realizimin e këtij operacioni e ka bërë NPK "Hortikultura" me asistimin e Policisë së Kosovës.
- **Këshillime profesionale të fermerëve:** Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural është realizuar projekti "Dhënia e këshillave fermerëve" me që rast u janë dhënë këshilla fermerëve të tri kategorive: fermerëve ekzistencial, fermerëve gjysmë komercial dhe fermerëve komercial.
- **Procesi i korrje-shirjeve:** Me qëllim që procesi i korrje-shirjeve të jetë sa më i suksesshëm. Sektori i Bujqësisë ka realizuar një sërë vizitash në terren, me ç'rast është bërë vlerësimi i kulturave me drithëra të bardha si dhe verifikimi dhe

evidentimi i gjendjes dhe numrit të auto-kombajnave, dhe në funksion të kësaj gjatë muajit qershor është organizuar takim me pronarët e auto-kombajnave, të cilët janë informuar rreth çmimit të korrje-shirjes, subvencioneve në derivate të naftës etj. dhe njëzëri është konstatuar se për të pas një fushatë të suksesshme duhet një angazhim i përbashkët i të gjitha strukturave të përfshira në këtë proces. Në procesin e korrje-shirjeve kanë marrë pjesë 21 kombajna. Çmimi i korrjes sillej prej 90€/ha duke u bazuar në faktin se M.B.P.ZH.R. ka bërë subvencionimin në derivate të naftës për auto-kombajner. Rendimentet e grurit silleshin prej 3.500 kg/ha, të tërshërës 2.800 kg/ha dhe elbit 3.200 kg/ha. Sipërfaqet e përgjithshme të mbjella me drithëra të bardha kanë qenë 2.020 ha (grurë 1.940 ha, tërshërë 65 ha dhe elb 15 ha).

- **Realizimi i mbjelljeve vjeshtore:** Procesi i mbjelljeve është realizuar sipas planifikimeve dhe se kushtet klimatike kanë qenë të volitshme për mbjelljen e kulturave vjeshtore. Sipërfaqet mbjella me kultura vjeshtore në vitin 2010 kanë qenë më të vogla se sa vitin paraprak dhe në bazë të dhënave në këtë vit janë mbjell gjithsej 1,295 ha (1,250 ha grurë dhe 45 ha bimë farogjere).
- **Subvencionimi i fermerëve për mbjellje vjeshtore:** Me qëllim të subvencionimit të fermerëve për mbjelljet vjeshtore komuna e Prishtinës ka ndarë 50.000,00€ dhe se nga kjo shumë kanë përfituar gjithsej 296 fermer, ku secili fermer ka përfituar nga 168.90€ për mbjelljen e një sipërfaqeje prej 1 ha me grurë.

c. Sektori i pylltarisë

Që nga transferimi i kompetencave dhe përgjegjësi nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës (APK) në Komunë (që është bërë më datë 15/07/2010) lidhur me mbrojtjen dhe ruajtjen e pyjeve në territorin e komunës së Prishtinës, Autoriteti Pyjor Komunal ka zhvilluar një aktivitet me qëllim të përmirësimit të gjendjes në këtë sektor. Edhe pse janë arritur disa rezultate prapë mbesin sfida të mëdha për përmirësimin dhe konsolidimin e këtij sektori të rëndësishëm. Gjatë periudhës Korrik-Dhjetor 2010 janë konfiskuar 62.5 m³ masë drusore. Janë iniciuar në procedurë gjyqësore gjithsej 40 lëndë, ndërsa janë në procedurë të inicimit 35 lëndë për prerësit ilegal të pyjeve. Në bashkëpunim me APK-në është bërë pyllëzimi i sipërfaqes prej 5 ha. Ka filluar evidentimi i dëmeve të shkaktuara në pyjet publike, mirëpo ky proces është ndërprerë përkohësisht për shkak të kushteve klimatike dhe se do vazhdoj menjëherë me përmirësimin e kushteve klimatike.

10. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUNMM), në Komunën e Prishtinës, punët dhe detyrat nga përgjegjësia e vetë i ka realizuar përmes sektorit të urbanizmit, sektorit të ndërtimit dhe sektorit të mbrojtjes së mjedisit. Fushë veprimtaria dhe punët e kësaj drejtorie kryesisht janë bazuar në planifikimin e hapësirës në tërë territorin e komunës, kontrollimin dhe mbikëqyrjen e ndërtimeve në terren, mbrojtjes së mjedisit, në plotësimin e kërkesave të qytetarëve nga sfera e urbanizmit ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit si dhe aktiviteteve tjera përcjellëse profesionale.

a. Sektori i urbanizmit

Sektori i Urbanizmit përbëhet nga shërbimi i Planifikimit dhe shërbimi i Urbanizmit.

Shërbimi i planifikimit

Ky sektor ka punuar në përgatitjen, koordinimin dhe qasjen në hartimin e planeve rregulluese, përgatitjen e detyrave projektuese dhe dokumentacionin tenderues për planet rregulluese, mbajtjen e punëtorive, debateve, prezantimeve si dhe mbajtjen e diskutimeve publike për planet rregulluese.

Janë përcaktuar lagjet për hartimin e planeve rregulluese. Është përgatitur plani detal-zbatues urbanistik për Lagjen Mati-III. Gjatë vitit 2010 janë miratuar planet rregulluese për Lagjen e Muhaxhirëve dhe Lagjen “Qyteza Pejton”. Është bërë plotësim-ndryshimi i planit rregullues për Lagjen Mati-I. Në proces të përfundimit të hartimit janë planet rregulluese për: Zonën Ekonomike, Lagjen Vellusha dhe Lagjen Medresa-Çamëria.

Procesi i hartimit të planeve rregulluese është përcjell me organizimin e një numri të konsiderueshëm të punëtorive me kompanitë e përzgjedhura për hartimin planeve, me stafin profesional të drejtorisë dhe me komisionin profesional. Në pajtim me dispozitat ligjore janë organizuar edhe takimet tjera procedurale, takimet me qytetarë, biznese, si për konsultime urbane po ashtu dhe për diskutime publike. Gjithashtu për shumë lagje në fazën e implementimit të planeve rregulluese janë mbajtur takime konsultative për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve urbanistiko-arkitektonike. Për tërësitë e veçanta të blloqeve urbanistike janë formuar komisionet profesionale për rishqyrtimin e gjendjes faktike dhe formës së aplikuar të implementimit të zgjidhjeve urbanistiko-arkitektonike në mikrolokacione dhe mënyrës së inkorporimit të tyre në bllokun urbanistik.

Janë hartuar detyrat projektuese për hartimin e planeve rregulluese për lagjet: Prishtinën e Re, zona Historike, Kodra e Trimave I dhe II, dhe Mati II. Po ashtu detyrat projektuese për: Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal për Prishtinën, Hartimin e Planit Zhvillimor Urban për Prishtinën, Hartimin e Projekteve urbanistiko-arkitektonike dhe themelim të sistemit të GIS-it. Shumica prej këtyre tani janë në fazën e tenderimit. Po hartohen projektet Sheshin Zahir Pajaziti, Sheshin Adem Jashari dhe Sheshin i Pavarësisë.

Shërbimi i Urbanizmit

Përmes këtij shërbimi janë përcaktuar lokacionet për objektet me karakter shoqëror, konform Planit Strategjik Zhvillimor Urban. Janë përgatitur materialet me propozimet grafike, në bazë të të cilave janë hartuar edhe propozim vendimet me arsyetimet përkatëse. Për komplekse dhe objekte të natyrave të ndryshme janë përcaktuar këto lokacione: lokacioni për Objektin e Zjarëfiksve, lokacioni për Shkollën e Mesme në Kalabri, lokacioni për Shkollën fillore në Arbëri, lokacioni për Shkollën fillore te tjegullorja, lokacioni për Objektin e banimit për veteranët e luftës dhe objektin social, lokacioni i tregut për shitjen e kafshëve dhe rërës, lokacionet për toaleta publike, terrenet sportive, fontana etj. Në shqyrtim janë hapësirat për lokacionet e tregut për shitjen e druve, për spitalin e qytetit, shtëpinë e pleqve, stacionit policor, për patinazh dhe objektin multikulturor.

DUNMM ka punuar ngushtë me drejtoritë e tjera komunale në përcaktimin e rrjetit infrastrukturor, rrjetit të institucioneve shkollore dhe shëndetësore, terreneve sportive, objekteve të kulturës, parqet, depozitë dhe hapësirat e tjera publike. Është përgatitur raporti detal për ndërtimet kolektive për periudhën 2006-2010. Për lokacionet e caktuara për ndërtimin e objekteve për të cilat ka qenë investitor komuna, është përgatitur i tërë

dokumentacioni tekniko investiv, detyrat dhe programet projektuese për shpalljen e tenderëve.

Gjatë periudhës raportuese në DUNMM kanë arritur 1,589 kërkesa përmes zyrës pritëse dhe 455 kanë ardhur drejtpërdrejtë në drejtori nga organet tjera komunale, që në total është 2,044 kërkesa. Nga viti paraprak janë bartur 163 kërkesa. Kështu që gjatë vitit 2010 në drejtori, nga të gjitha sektorët dhe shërbimet janë shqyrtuar 2207 lëndë, prej të cilave 434 si të tilla ishin kërkesa të përsëritura, ndërsa 1,610 kërkesa të reja. Prej tyre, 1899 janë trajtuar dhe zgjidhur në forma të ndryshme (shih tabelën më poshtë), ndërsa 308 janë në procedurë e sipër. Të hyrat nga lëshimi i lejeve të ndërtimit për vitin 2010 janë në vlerë prej 8,560,798.68 €

Forma e zgjidhjes së kërkesave nga DUNMM

Nr.	Përshkrimi	2010	2009
1	Njoftime	59	194
2.	Informime	921	65
3.	Refuzime	96	199
4.	Të Miratuara si akte të ndryshme	266	513
5.	Pëlqime	75	121
6.	Numri i Lejeve Urbanistike	236	282
7.	Numri i Lejeve të Ndërtimit	177	33
8.	Konkluzë	47	08
9	Leje paraprake	7	
10	Interpretim ligjorë	3	
11	Kushte në lokacion	3	
12	Leje për Aneks	5	02
13	Leje për rrënim	4	163
	Gjithsej	2.207	1.570

b. Sektori i ndërtimit

Ky sektor në bazë të detyrave programore, kryesisht është marrë me përpunimin e lëndëve në fushën e ndërtimit si, hartimin e detyrave projektuese, mbikëqyrjen e objekteve, formimin komisioneve profesionale, caktimin e komisioneve për pranimin teknik të objekteve, dhënien e lejeve për përdorim të objekteve si dhe veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me këtë sektor. Janë përpunuar lëndët që kanë të bëjnë me: lejet e përdorimit, pranimet teknike, gjendjen ekzistuese të objekteve dhe përgatitjen e preventivës së nevojshme, informimin e qytetarëve lidhur me infrastrukturën e planifikuar, problemet e stabilitetit të objekteve si dhe me planifikimin e infrastrukturës.

Në këtë periudhë sektori i ndërtimit ka hartuar detyrat projektuese për rrugët: “Ahme Krasniqi”, “Ekrem Rexha”, “Ndue Përleshi”, rrugët në lagjen “Lakrishte”, rrugës për shkollën “Xhevdet Doda”, dhe rrugës mes bllokut “B”, rrugës “A” në lagjen “Mati 1”. Gjithashtu është punuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese dhe programi investues për renovimin e QMF-ve në Prishtinë, rrezikun nga rrëshqitja e dheut dhe ndërtimin e murit mbrojtës në rrugën “Gon Sereqi”, vlerësimin e gjendjes dhe përgatitjen e materialit tenderues për ndërtimin e garazheve për zjarrfikësit, vlerësimin e lokacioneve dhe përgatitjen e materialit tenderues për ndërtimin e toaleteve publike.

Sektor i ndërtimit gjithashtu ka bërë mbikëqyrjen e projektimit dhe ndërtimit të të gjitha shkollave dhe anekseve shkollore të ndërtuara nga komuna, të terreneve sportive dhe sallave

të edukatës fizike, bibliotekës së qytetit, qendrës kulturore të fëmijëve, objektit të zjarrfikësve, qendrave të mjekësisë familjare, renovimit të objektit të komunës etj. Po ashtu ka mbikëqyrë ndërtimin e projekteve infrastrukturore në bashkëpunim me Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale. Ka punuar në projektimi i unazës së brendshme (pjesa lindje dhe perëndim), të rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore për lagjet e urbanizuara, të paurbanizuara dhe në fshatra.

Në kuadër të drejtorisë janë krijuar komisione profesionale për vlerësimin e: objektit të Hotel “Unionit”, të Hotel Ilirisë dhe Hotel Grandit, të fasadës dhe nënkulmit të ndërtesës administrative të KOSTIT sh.a., të stabilitetit të xhamisë “Hasan Emini”; të stabilitetit të objektit të kolektori, të nyjelloreve të auto udhës dhe unazës së brendshme etj. Ky sektor ka bërë vlerësimet dhe pranimet teknike për 64 objekte kapitale të ndryshme. Gjithashtu është punuar në dhënien e lejes së përdorimit dhe lejes së shëndrimit për këto objekte: Fshati ndërkombëtarë (100 leje përdorimi për objekte individuale), leje të shndërrimeve në dy raste ndërsa një është në procedurë, leje përdorimi për objekte të banimit kolektiv etj.

c. Sektori i mbrojtjes së mjedisit

Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit edhe pse përballet me mungesë të stafit, ka kryer punët në pajtim me detyrat programore duke u mbështetur në dispozitat ligjore të aplikueshme, rregulloret dhe vendimet e Kuvendit Komunal. Gjatë periudhës raportuese ka bërë njoftime në lidhje me mbrojtjen e ambientit (tokës, ujit dhe ajrit) siç janë: kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, trotualet, ujërat e zeza, si dhe zhurmat e shkaktuara nëpër lokale afariste si dhe nga gjeneratorët. Në kuadër të sektorit janë zhvilluar aktivitet rreth bashkëpunimit profesional me institucionet përkatëse si me “Qendrën rajonale e mjedisit-REC” në bashkëpunim me MMPH - Agjencioni për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës, me GTZ lidhur me “Planin komunal për menaxhim të mbeturinave” dhe është arritur një marrëveshje bashkëpunimi për donacion për menaxhim të mbeturinave.

d. Zhvillimi profesional i stafit

DUNMM në këtë periudhë zhvilloi edhe aktivitete të tjera profesionale si pjesëmarrje në: trajnime, punëtori, debate, konferenca, kongrese, vizita bashkëpunimi, prezantime, takime të ndryshme pune, me përfaqësues të institucioneve të nivelit lokal, qendror, ndërkombëtar, të OJQ-ve, qytetarë etj. Stafi i DUNMM ka marrë pjesë në trajnimin “Planifikimi Hapësinor Urban dhe Luftimi i Ndërtimeve të Paligjshme” në Kroaci, “Mbrojtja e mjedisit, çështjet urbane dhe ndërtimi” në Bullgari, trajnimi dy mujorë në Japoni nga Agjencioni i Japonisë për bashkëpunim ndërkombëtar “Jica”. Stafi ka marrë pjesë në shumë punëtori të organizuar në Kosovë nga institucione të ndryshme si dhe konferenca në Kosovë dhe jashtë, si në Stamboll, Vjenë, Slloveni, Gjermani, Maqedoni, Kroaci etj.

Në këtë periudhë në kuadër të drejtorisë janë zhvilluar shumë takime, diskutime, konsultime me palë, me zyrtarë të nivelit lokal, qendror, ndërkombëtar, gazetarë etj. Konsiderohen që janë zhvilluar mbi 3210 takime.

e. Sektori i Legalizimit

Gjatë kësaj periudhe raportuese është punuar në përgatitjen e strukturës organizative për legalizim, vlerësimi i manualit për trajtimin e ndërtimeve ilegale dhe përgatitjen e procedurës për aero-incizim. Njëherësh është formuar “Sektori i Legalizimit” i cili është në

konsolidim e sipër – me staf dhe hapësirë punuese adekuate. Në adresë të sektorit deri me 31.12.2010 kanë arritur gjithsejtë 6147 kërkesa. Këto kërkesa do të trajtohen konform kushteve dhe kritere të parapara me rregullativën ligjore.

11. DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE

Drejtorja e Infrastrukturës Lokale gjatë vitit 2010 ka kryer këto aktivitete: hartimi i detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave, shqyrtimi i kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkorporimi i tyre në planet e komunës, njoftimi me kohë i kompanive publike dhe subjekteve relevante me qëllim të koordinimit të punëve, incizimi i gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, hartimi i paramasave dhe parallogarive si dhe kompletimi i dokumentacionit teknik për procedimin e tyre si dhe mbikëqyrjen e realizimit të projekteve konform marrëveshjes.

a. Hartimi i detyrave projektuese

Duke marrë për bazë ligjin mbi planifikimin hapësinorë, ligjin mbi ndërtimin e objekteve investive si dhe ligjin për projektim e në veçanti planet rregullative, janë hartuar detyrat projektuese për këto rrugë në zonat urbane:

1. hartimi i projektit për rrugët rreth stadiumit
2. hartimi i projektit për rrugën “Shkupi-kolexhi në Veternik”
3. hartimi i projektit për rrugën “Ndue Përlleshi”
4. hartimi i projektit për rrugën “Ahmet krasniqi dhe Ekrem Rexha”
5. hartimi i projektit për kolektorin fekal dhe atmosferik pranë lumit “Prishtina”
6. hartimi i projektit për rrugën “Tomori”
7. hartimi i projektit për rregullimin e përroit “Vellusha”
8. hartimi i projektit për rrugën “Gjergj Balsha”
9. hartimi i projektit për rrugën “Varreza-Shkabaj”
10. hartimi i projektit për rrugën “Holger Petersen”
11. hartimi i projektit për rrugën “Malush Kosova”(vazhdimi)
12. Hartimi i projektit për vazhdimin e zgjerimit të rrugës “Vëllezrit Fazliu-Lebanë

Po ashtu janë kryer detyra projektuese edhe për këto rrugë rurale:

1. hartimi i projektit për rrugën Prishtinë-Sinidoll-Bardhosh
2. hartimi i projektit për rrugën në fshatin Trudë
3. hartimi i projektit për rrugën në fshatin Mramor-lagja Spahiaj
4. hartimi i projektit për rrugën në Vranidoll-lagja e poshtme
5. hartimi i projektit për rrugën në fshatin Marec (Viti-Bullaj)
6. hartimi i projektit për rrugën në fshatin Keqekollë-lagja Kaqot
7. hartimi i projektit për rrugën në fshatin Glllogovicë deri te shkolla
8. hartimi i projektit për kanalizimin fekal në Shkabaj

Gjatë hartimit të projekteve nga kompanitë fituese të tenderit është kërkuar që këto kompani të kenë kontakte të vazhdueshme me drejtoratin komunal dhe kompanitë publike për përvetësimin e varianteve më të volitshme për projektimin e rrugëve dhe kanalizimeve.

b. Hartimi i projekteve dhe përgatitja për ofertim

Duke u bazuar në kërkesat e shumta të qytetarëve për rregullimin urgjent të infrastrukturës rrugore në lagjet e tyre dhe domosdoshmëria e intervenimit, ekipi teknik hartoi këto projekte dhe paramasa:

Projektet të kontraktuara në vitin 2010

Nr.	Emri i rrugës
1	Bill Klinton
2	Rindertimi i rruges „Ulqini"
3	Ndertimi i rruges -Ali Pashë Gucia-Demë Ahmeti
4	Riparimi i gropave ne rruget e qytetit
5	Rindertimi i rruges ne lagjen Vërbovc te Barileves
6	Rindertimi I rruges „Malush Kosova" faza e II-të
7	Asfaltimi rruges„Bardhosh Milevc" faza e II
8	Rindertimi I rruges„Hilmi Rakovica"
9	Rindertimi I rruges „Vlora"
10	Rindertimi I rruges„Kadri Zeka"
11	Asfaltimi I rruges ne Trudë
12	Rindertimi I rruges nga magjistralja Prishtinë-Gjilan deri ne Lagjen e Byqmetve ne Hajvali
13	Ndertimi I kanalizimit fekale ne Barilevë
14	Rindertimi I shtigjeve te këmbesorve ne varrezat e qytetit
15	Rindertimi trotuarve dhe shtigjeve te këmbesorve ne parqe dhe qytet
16	Ndertimi I rrugeve lidhese ne mes te rrugeve„Tirana dhe Ahmet Kresniqi
17	Ndertimi I rrugeve lidhese me rruget„Vllezerit Fazliu"
18	Aneks Kontrata
19	Rindertimi I rruges „Ekrem Rexha" dhe garazheve te rreth rrotullimi ne Arberi
20	Ndertimi I trotuareve Bunari I Hajratit-Llukarë
21	Rr.Ismet Krasniqi
22	rr.Vranidoll-Serovc
23	trotuaret në hajvali
24	Muharrem Fejza
25	Rindertimi I rruges në Arberi (mbrapa ambasadës Amerikane)
26	Ndërtimi I rrugës paralele Prishtinë – Shkup
27	Asfaltimi I rrugës në barilevë
28	Ndërtimi I kanalizimit fekale në Bërnice e ulët
29	Ndërtimi I rrugës Agim Ramadani
30	Rindërtimi I rrugës dhe kanalizimit fekal në lagjen Përroi I Njelmët
31	Ndërtimi I vazhdimit të rrugës Enver Maloku
32	Ndërtimi I vazhdimit të rrugës Hyzri Talla
33	Sanimi I rrugëve Dëshmorët e Marevcit Bedri Shala dhe parkingu prapa rrugës Robert Doll
34	Sanimi I rrugëve Bajram Bahtiri , Mic Siokoli rrugës lidhëse A.Frashëri , G.Tërbeshi Lidhja e Prizërenit ,Sh.Kamberi,Naser Hajrizi
35	Ndërtimi I kanalizimit dhe rrugës prapa shkollës „Gjin Kazulli"
36	Rindërtimi I rrugëve te Medresa në Prishtinë

37	Rindërtimi I rrugëve në lagjën Kalabria
38	Ndërtimi I kolektorit atmosferik mbi lumin, „Prishtina” ne lagjen Kalabria
39	Ndërtimi I rruges ne Lebane dhe Kanalizimi fekal ne lagjen „Prugovc” 2
40	Rregullimi I rruges dhe platos rreth Stadiumit futbollistik
41	Vazhdimi I rruges Hollgen Petersen
42	hartimi I projektit për rrugën "Ndue Përleshi"
43	hartimi I projektit për rrugët "Ahmet krasniqi dhe rrugët lidhëse me rr.Ekrem rexha
44	Hartimi I projektit për kolektorin fekal dhe atmosferik pranë lumit "Prishtina"
45	hartimi I projektit për rregullimine prroit Vellusha dhe rr."Tomori"
46	hartimi I projektit për rrugën "Viti-Bullaj"
47	Hartimi I projektit zbatues për rr."Gjergj Balsha Vranidoll dhe kanalizimit në Shkabaj
48	Riparimi I rrugeve rurale
49	Rindërtimi I rruges „Mbreti Longar” dhe „Ndre Mjeda"
50	Ndërtimi I rruges „Gjergj Balsha"
51	Rruga Leka I Madhë dhe muri mbrojtës Demë Ahmeti
52	Rrugët Hoxhë Tahsini, Ismet Jashari Nikolla Teslla, Hil Mosi dhe Janina
53	Kanalizimi fekal, „Shkabaj” dhe muret mbrojtëse ne rrugen Ismet Krasniqi
54	Agim Ramadani-shtesa
55	Sanimi I rrugeve te qytetit +kanalizimet
56	Riparimi I rruges lidhese Grashtic-Mramor
57	Rindërtimi I rrugeve Skender Anamali, Peshteri Pashtriku dhe Nazim Berati

c. Projektet infrastrukturore

Projektet infrastrukturore të kontraktuara më 2009 dhe të përfunduara më 2010 janë:

1. Ndërtimi i kolektorit atmosferik dhe rruga mbi lumin Prishtina
2. Rrugët te Fusha e Pajtimit: Murat Xhakla, Esat Berisha, Xhelal Hajda, Nasjet Selimi, Jashar Erebara
3. Nasret Krasniqi
4. Ndërtimi I rrugëve në lagjën Kalabria dhe Trotuaret në Kuvendin e Bujanit
5. Hollgen Petersen Sofali
6. Rruga Nexhmedin Llumnica me rrugët lidhëse
7. Rrugët Xheladin Deda Petro Marko Ramë Vllasi Kanalizimi fekal
8. Ndërtimi I rrugës, „ Ernest Zariqi"
9. Ndërtimi I kanalizimit në lagjën Prugovc lagja II
10. Ndërtimi I kanalizimit në lagjën Prugovc
11. Ndërtimi I rrugëve dhe terenit sportiv në Bregun e Diellit
12. Lagja Janina „Aleksander Gjuvani
13. Ndërtimi I Rruges Kolovicë, Sofali, Ali Ajeti dhe Mat-Lagja e Krasniqeve
14. Ndërtimi i rrugës B.

d. Projektet e bartura më 2011

Me gjithë angazhimin maksimal, nuk është arritur që në qendër të qytetit të trajtohen disa rrugë edhe pse projektet kanë qenë të gatshme si: rruga e “UÇK-ës”, ”Fehmi Agani”, ”Rrustem Statovci”, ”Ilaz Kodra”, vazhdimi i Sheshit ”Nëna Terezë”. Kjo ka ardhur për shkak të ndërrimit të gypit të ujësjellësit kryesorë i cili kalon nëpër qendër të qytetit. Ky investim është bërë nga Banka Gjermane e po ashtu edhe menaxhimi. Po ashtu edhe ndërtimi

për zgjerimin e rrugës “Bill Clinton” ka ndikuar në mos përfshirjen e disa rrugëve në qendër për shkak se do të vështirësohej qarkullimi në komunikacion.

Mos përfundimi me kohë i disa projekteve ka ardhur si rezultat i problemeve pronësore që janë paraqitur gjatë ekzekutimit të punëve dhe për arsye të vonesave të shpronësimit të paraparë në bazë të ligjit përkatës. Pas përgatitjes së elaboratit të shpronësimit duhet të dërgohet në Ministrinë e Financave për tu vlerësuar, siq është rasti me rrugën “B”, “rrugën paralele”, rrugën “Muharrem Fejza”, rrugën “Gjergj Balsha”, rrugën “Enver Maloku”, kolektorin pranë lumit Prishtina. Disa projekte ka qenë e pamundur të implementohen gjatë muajve të vjeshtës, sidomos projektet që kanë të bëjnë me asfaltim. Pastaj, në disa raste po ngec edhe koordinimi me KEK-un në vendosjen e rrjetit elektrik dhe me ujësjellësin, pasi të dy këto kompani janë nën menaxhim të qeverisë. Të gjitha kompanitë publike janë njoftuar me kohë me planprogramin investiv për vitin 2010.

Si pasojë e të gjitha këtyre problemeve për vitin 2011 barten këto projekte si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emri i rrugës
1	Bill Klinton
1	Rindertimi I rruges, Hilmi Rakovica"
2	Ndertimi I rruges lidhese ne mes te rruges, „Tirana dhe Ahmet Kresniqi
3	Ndertimi I rruges lidhese me rruget, Vllezerit Fazliu"
4	Muharrem Fejza
5	Ndërtimi I rrugës paralele Prishtinë – Shkup
6	Ndërtimi I kanalizimit fekal në Bërnice e ulët
7	Ndërtimi I rrugës Agim Ramadani
8	Ndërtimi I vazhdimit të rrugës Enver Maloku
9	Ndërtimi I vazhdimit të rrugës Hyzri Talla
10	Sanimi I rrugëve Bajram Bahtiri , Mic Siokoli rrugës lidhëse A.Frashëri , G.Tërbeshi Lidhja e Prizërenit ,Sh.Kamberi,Naser Hajrizi
11	Ndërtimi I kanalizimit dhe rrugës prapa shkollës „Gjin Kazulli"
12	Rindërtimi I rrugëve te Medresa në Prishtinë
13	Rindërtimi I rrugëve në lagjen Kalabria
14	Ndertimi I kolektorit atmosferik mbi lumin, „Prishtina" ne lagjen Kalabria
15	Ndertimi I rruges ne Lebane dhe Kanalizimi fekal ne lagjen „Prugovc" 2
16	Rregullimi I rruges dhe platos rreth Stadiumit futbollistik
17	Vazhdimi I rruges Hollgen Petersen
18	Rindertimi I rruges „Mbreti Longar" dhe „Ndre Mjeda"
19	Ndertimi I rruges „Gjergj Balsha"
20	Rruget Leka I Madhë dhe muri mbrojtës Demë Ahmeti
21	Rruget Hoxhë Tahsini, Ismet Jashari Nikolla Teslla, Hil Mosi dhe Janina
22	Kanalizimi fekal, „Shkabaj" dhe muret mbrojtëse ne rrugen Ismet Krasniqi
23	hartimi I projektit Bërnice e Ulët-Lebanë
24	Sanimi I rruges te qytetit +kanalizimet
25	Riparimi I rruges lidhese Grashtic-Mramor

26	Rindertimi I rrugeve Skender Anamali, Peshteri Pashtriku dhe Nazim Berati
27	Ndërtimi I rrugëve dhe platove në lagjën Dardania Vehbi Ibrahim Dem Ahmeti
28	Ndërtimi I unazës Qendër pjesa e dytë
29	Ndërtimi I kanalizimit në lagjën Prugovc lagja II
30	Ndërtimi I kanalizimit në lagjën Prugovc
31	Ndërtimi I rrugës,,B"

Pjesa më e madhe e këtyre rrugëve janë në përfundim por për shkak të kohës nuk kemi lejuar të bëhet asfaltimi pasi që temperaturat në muajin nëntor dhe dhjetorë kanë qenë më të ulëta se 18°C. Asfaltimi do të bëhet në gjysmën e parë të vitit 2011. Kjo ka bërë që një pjesë e buxhetit të vitit 2010 të bartet në vitin 2011, për shkak se mesatarisht 30% të shumës së mjeteve të kontraktuara janë të konstruksioni i asfaltit.

Pasqyra financiare e projekteve të bartura në vitin 2011 është paraqitur në tabelën në vijim.

Pasqyra financiare e projekteve të bartura më 2010

	vlera	pagesat 2010	Mbetjet nga projektet	bartje 2011
Kontratat e vitit 2009 te përcjella në vitin 2010	2,675,781.12	2,066,904.82	0.00	608,876.30
Kontratat e vitit 2010	16,339,522.35	9,228,140.17	63,400.91	7,047,981.27
Gjithsej	19,015,303.47	11,295,044.99	63,400.91	7,656,857.57

e. Vëllimi fizik i projekteve të realizuara

Në tabelën në vijim është paraqitur vëllimi fizik i projekteve infrastrukturore të realizuara gjatë vitit 2010.

Vëllimi fizik i projekteve të realizuara

I.		Njësia matëse
1.	Rrugët e ndërtuara me pllaka	24,821.50 m ²
2.	Rrugët e ndërtuara me asfalt	241,117.56 m ²
3	Trotuaret me pllaka	126,034.94 m ²
4.	Kanalizime fekale	32,619.95 metra gjatësi
5.	Kanalizime atmosferike	113,41.85 metra gjatësi
6.	Ujësjiellës	6,961.48 metra gjatësi
7.	Gjatësia totale e rrugëve të ndërtuara	62,298.51 metra gjatësi

f. Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë vitit 2010 drejtorja ka pranuar 412 kërkesa të ndryshme të bashkësive lokale dhe banorëve: për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve, kërkesa nga kompanitë publike-leje për gropim dhe intervenime për sanimin e defekteve të ndryshme, kërkesa nga kompanitë për formime të komisioneve për kontrollimin e punëve, kërkesa të natyrave të ndryshme rreth definimit të zgjidhjes në teren etj. Nga numri i përgjithshëm prej 412 kërkesave të pranuar, të gjitha janë zgjidhur.

12. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

a. Sektori i Shërbimeve Publike

i. Shërbimit të Transportit dhe Trafikut

Gjatë kësaj periudhe, ky shërbim ka qenë kryesisht i përqendruar në aktivitetet rreth transportit publik, sinjalizimit në përgjithësi, parkingjeve, transportit me merimangë, mirëmbajtjes së semaforëve dhe punëve tjera. Në kuadër të angazhimit të avancimit të transportit, është përgatitur plani i ri për riorganizimin e shërbimit të trafikut publik të udhëtarëve dhe rregullorja përkatëse që rregullon këtë sferë. Po ashtu është bërë vazhdimi i orareve për operimin e kompanive nëpër linjat urbane si dhe linjat për Fushë Kosovë dhe fshatrat e Fushë Kosovës në përputhje me rregulloren në fuqi. Është bërë menaxhimi i shërbimit me merimangë dhe i parkingut në Zonën Industriale në të cilin parking vendosen automjetet e konfiskuara nga policia e Kosovës.

Janë rezervuar vendparkimet për institucionet shtetërore të vendit dhe të huajat pa pagesë, si dhe për subjektet fitimprurëse me pagesë. Po ashtu janë mirëmbajtur shenjat vertikale dhe horizontale ekzistuese të komunikacionit nëpër rrugët e territorit të Komunës dhe janë vendosur shenjat e reja sipas nevojës. Ky projekt (sinjalizimi) kishte vlerën kontraktuese 76.405,00€ DSHPMSH-sektori përkatës ka bashkëpunuar vazhdimisht me PK-ën-Drejtorinë e Trafikut dhe Policinë Regjionale të Prishtinës në fushën e rregullimit të funksionimit të trafikut në Komunën e Prishtinës. Nga Shërbimi me Marimangë janë krijuar të hyra 217.372,62€ ose në krahasim me vitin paraprak 16 % më shumë, kurse nga parkingjet 77.010,00 € Në krahasim me vitin 2009 në këtë fushë janë krijuar të hyra më pak për shkak të heqjes së parkingjeve në rrugën “Garibaldi”, rrugën “Fehmi Agani” dhe punimeve në Bulevardin “Bill Clinton”.

ii. Shërbimi i Energjetikës

Gjatë vitit 2010 Shërbimi i Energjetikës ka punuar në mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e semaforëve, vërtetimin e faturave për shpenzimin e energjisë elektrike të ndriçimit publik dhe të semaforëve, përpilimin e ofertave në bazë të projekteve të ndriçimit publik dhe të semaforëve. Për mirëmbajtjen dhe sanimin e ndriçimit publik, për vitin 2010 janë shpenzuar 112,202.00 € në mirëmbajtjen e ndriçimit në 256 rrugë me ndriçim të lartë dhe hapësira tjera publike me ndriçim të ultë. Në mirëmbajtjen e semaforëve për vitin 2010 janë shpenzuar 58,959.00€ Shpenzimi i energjisë elektrike i ndriçimit publik dhe i semaforëve, është regjistruar nga 114 grupe matëse të aktivizuara dhe për këtë Komuna ka paguar 112.721,00€ Gjatë këtij viti kemi realizuar projektin për ndërrimin e trupave ndriçues ekonomik në disa rrugë të Prishtinës, në bashkëpunim me MEM –in dhe GTZ-në në vlerë prej 48320,00€ (investim i përbashkët). Po ashtu, është përgatitur projekti për vazhdimin e zëvendësimit të trupave ndriçues ekzistues me ata ekonomik dhe është dërguar në procedurë të mëtejme të prokurimit.

iii. Shërbimi për mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese dhe hapësirave tjera publike

Gjatë këtij viti janë mirëmbajtur 514,087 m² sipërfaqe të gjelbëruara dhe janë shpenzuar 341,101.45€ Gjatë vitit 2010 në qytet është bërë rregullimi i sipërfaqeve të reja gjelbëruese në sh.f.”Xhemajl Mustafa”, në rrugën “Idriz Gjilani”, në Ulpianë, në rrugën “Kosta

Novaković” dhe në rrugën “Rrahim Beqiri”. Po ashtu gjatë zezonës përkatëse janë mbjell fidane dhe lule sezonale në rrugën “Agim Ramadani”, në lagjen Dardania, në “Varrezat e Dëshmorëve”, në Arbëri, Ulpianë, në sh.f. “Asim Vokshi”, sh.f. “Zenel Hajdini”, në sh.f. “Ismail Qemali”, sh.f.”Xhavit Ahmeti”, në Fshatin e Fëmijëve, në sheshin “Nëna Terezë” dhe sheshin “Zahir Pajaziti”. Këto punë janë realizuar nga NPK.”Hortikultura”. Mirëmbajtja e gjelbërimit në oborret e institucioneve shkollore të lartpërmendura dhe institucioneve parashkollore në vlerë prej 59.780,28€ është realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Gjithashtu janë mirëmbajtur edhe Parku i Gërmisë, Parku i Vjetër i Qytetit, Parku te SHMEJ ”Hoxhë Kadri Prishtina”, Parku i Arbërisë, zona rreth liqenit të Badocit dhe sipërfaqe tjera kudo brenda qytetit.

Prapa Pallatit të Rinisë dhe Sportit është rregulluar parkingu për traktor taxi dhe kamion, tregu për shitjen e druve dhe rërës në Fushën e Pajtit, projekte këto në vlerë 29.739,50€ Projekti tjetër i rëndësishëm ka qenë vendosja e 530 shportave dhe mirëmbajtja e tyre për 12 muaj, në vlerë prej 30.950,00€ ndërsa në bashkëpunim me USAID-in është realizuar projekti për rregullimin e shkallëve të Arbërisë dhe parkun në rrugën”Afrim Loxha” në vlerë prej 74.000,00€. Po ashtu kanë përfunduar punimet për rregullimin e deponisë së vjetër të qytetit (mbulimin e saj me dhe tipik, është bërë hapja e rrugëve për shfrytëzimin e hapësirës tetëhekterëshe, është bërë shpimi për ajrosjen e brendisë së deponisë, po vazhdon mbjellja me fidane bagrem i bardhë, mbjellja e barit, është bërë drenazhimi, rrethoja si dhe rregulluar mirëmbajtja e përhershme). Ky projekt ka kushtuar 1.100.000,00€ donacion nga Komisioni Evropian i realizuar në bashkëpunim me komunën.

iv. Shërbimi për mirëmbajtjen e rrugëve

Në mirëmbajtjen verore të rrugëve dhe trotuareve gjatë vitit 2010 në loton e I-rë dhe të III-të është kontraktuar SHPK “Toifor” në vlerë 200.334,89€ kurse në loton e II-të NPR “Pastrimi” në vlerë prej 11.9212,80€ ndërsa për mirëmbajtjen verore të rrugëve rurale është kontraktuar NPN “Dardania” në vlerë prej 72.000,00€ Për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve rurale në loton e I-rë është kontraktuar NN “VZ company” në vlerë 46.994.40€ kurse NPN “Dardania” për loton e II-ë në vlerë 38.960.00€ Po ashtu për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në qytet është kontraktuar, në loton e I-rë “Zahiri-Company” në vlerë 94.530.00€ në loton e II-të SHPK “Toifor” në vlerë 97.885.00€ kurse në loton e III-të NP “Pastrimi” në vlerë 96.800.00€ Këto kontratat janë në realizim e sipër.

v. Shërbimi për shfrytëzimin e hapësirave publike

Edhe ky shërbim ka arritur të rris të hyrat në krahasim me të hyrat e vitit paraprak. Kështu nga qiraja e kiosqeve kanë hyrë 34.390,00€ nga reklamat 107499,00€ nga shfrytëzimi hapësirave publike për vendosjen e objekteve tjera si gjeneratorët, tendat, objektet lëvizëse etj. kanë hyrë 46.693,00€ nga tavolinat para lokaleve gjatë sezonit veror 136.513,00€ nga sezoni dimëror 11.596,30€ , nga vendosja e përkohshme e shkallëve 5351,00€ dhe nga parkingjet 77.010.00€. Poashtu nga laura në parkun Gërmia dhe tregu i automjeteve, duke filluar nga shtatori i vitit 2010 kanë hyrë 150.161.00€, ndërsa nga reklamat e dhëna me koncesion kanë hyrë 131.683.20€. Siq shihet nga shtatë llojet e hyrjeve të para të lartshënuara janë realizuar 785.646,52€ ose 130.44% , ndërsa kur i shtojmë të hyrat nga laura e Gërmisë dhe nga reklamat me koncesion të AMM-ës del se gjatë vitit 2010 kanë hyrë 1.067.490.70€, ose 22.77% më shumë se në vitin paraprak.

vi. Shërbimi ndërmarrjeve komunale publike

Ky shërbim është përqendruar në thellimin e bashkëpunimit me këto ndërmarrje me qëllim të ngritjes së cilësisë në shërbime dhe rritjen e shkallës së përgjegjësisë. Vlenë të theksohet se në NK "Hortikultura" dhe NPR "Pastrimi" është ngritur cilësia e shërbimeve ndaj qytetarëve, kurse në „Termokos” ka probleme të grumbulluara me vite si rezultat i mospagesës së faturave nga ana e konsumatorëve dhe ngritjes së çmimit të mazutit. Për tejkalimin e kësaj gjendjeje të rëndë, Komuna për vitin 2010 e ka subvencionuar këtë ndërmarrje me 500.000€ Poashtu edhe në NK, „Trafiku Urban “, pas masave reorganizuese, ka filluar të përmirësohet gjendja në shërbimin e transportit të udhëtarëve. Në fushën e menagjimit të mbeturinave, bashk me NPR "Pastrimi", në bashkëpunim me GTZ-ën kemi përfunduar Draft-planin për menagjimin e mbeturinave dhe Rregulloren për menagjimin e mbeturinave të cilin dokument, ky Kuvend, së shpejti do ta ketë para vetes për miratim, por pas miratimit të ndryshimit të Ligjit për mbeturina.

b. Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit

Aktivitetin e vet e ka zhvilluar përmes Brigadës së Zjarrfikësve të Prishtinës (BZP-ës), Qendrës për Informim, Alarmim dhe Koordinim (QIAK-ut) dhe zyrtarëve të administratës. Gjatë këtij viti janë realizuar me sukses trajnimet, ligjeratat këshilluese dhe seminarët e ndryshme në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të cilat kanë ndikuar pozitivisht në realizimin e objektivave tona. Po ashtu shërbimi përkatës ka vlerësuar shkallën e rrezikshmërisë për territorin e Komunës së Prishtinës përmes dokumentit "Vlerësimi i rrezikut nga fatekeqesite natyrore dhe nga fatekeqesite e tjera" i cili është aprovuar në Kuvendin e Komunës dhe njëkohësisht është hartuar Plani i punës së Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim. Është hartuar edhe Rregullorja dhe Plani vjetor i punës së KKSB-ës, pastaj Plani i evakuimit të personelit dhe i personave që gjenden në objektet e komunës në raste të rreziqeve të mundshme, është organizuar trajnimi me shërbyesit civil të komunës dhe janë organizuar ushtrimi praktike për mënyrën e evakuimit të personelit dhe palëve nga ndërtesa e re e komunës. Janë koordinuar aktivitetet me subjektet gjegjëse nga lëmia e Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Është përgatit raporti për KKMSH-ës lidhur me zbatimin e masave mbrojtëse kundër zjarrit gjatë fushatës së korrje -shirjeve. Janë përgatit materialet dhe raportet për KKMSH-ën, Këshillin Komunal për Siguri të Bashkësive (KKSB-ën)- dinamika e punës si dhe janë organizuar takimet e rregullta. Janë themeluar Ekipe të Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSBS).

Gjatë 2010 është organizuar vizita në shkollat fillore dhe të mesme (47 sosh) në territorin e Komunës së Prishtinës. Qëllimi i këtyre vizitave ka qenë verifikimi i organizimit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit në raste të ndryshme emergjente dhe parapërgatitjet për organizimin e ligjeratave për nxënësit me qëllim të realizimit të programit nga kjo sferë dhe njëkohësisht aftësimin e personelit në organizimin për mbrojtje dhe shpëtim në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, si shpëtimi nga shpërthimi i zjarrit, evakuimi i tyre, dhënia e ndihmës së parë, strehimi i tyre në vende të sigurta etj. Po ashtu janë mbajtur ushtrimet praktike për evakuimin e nxënësve, personelit arsimor dhe dokumentacionit në rast rreziku në shkollat fillore: "Hasan Prishtina, "Iliria" dhe "Ismail Qemajli". sipas planit. Ky projekt do të realizohet në të gjitha institucionet arsimore të Komunës së Prishtinës. Ky sektor ka punuar shumë edhe në formimin e këshillave të banimit në bashkësi.

i. Qendra për Informim, Alarmim dhe Koordinim

Si rëndom kjo qendër organizoi kujdestarinë 24 orësh, pa ndërprerje ku operatorët kujdestarë të qendrës marrin dhe japin informata të ndryshme nga qytetarët, nga institucionet dhe organet komunale. Qendra gjithëherë ishte dhe është e mobilizuar. Gjatë kësaj periudhe kohore është kujdesur për mirëmbajtjen e monitorëve në Komunë, ka mirëmbajtur radiolidhjet me BL-ët, ka bërë formatizimin e programit të sistemit të qasjes (hyrje - dalje) në laurën e Gërmisë, ka bërë verifikimin e të gjitha mjeteve teknike, verifikimin e radiolidhjeve, ka vendosur dy pika të sinjaleve të Alarmit Publik dhe ka përgatitur raportet ditore, javore dhe mujore. Ka përgatitur 250 kartela identifikimi ka pranuar më shumë se 2020 raste lajmërimi (informimi) nga qytetarët dhe subjektet komunale dhe punë të tjera sipas nevojës.

Inspektorët e parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit kanë realizuar këto punë

- kanë kontrolluar 143 objekte private dhe publike
- kanë hartuar 143 procesverbale
- kanë dhënë 699 masa mbrojtëse
- kanë hulumtuar 66 zjarre
- kanë lëshuar 21 vërtetime për djegien e objekteve dhe pasurive
- kanë dhënë 49 pëlqime - Elaborate për mbrojtje nga zjarri për objektet në ndërtim.

Inspektorët për MSH të këtij sektori kanë vizituar dhe inspektuar 22 shkolla fillore, 10 shkolla të mesme, 19 institucione parashkollore publike dhe private, kanë inspektuar 25 raste emergjente në bazë të kërkesave të qytetarëve, kanë urdhëruar 62 subjekte që të hartojnë Vlerësimet dhe Planet për Mbrojtje dhe Shpëtim në afat kohor të paraparë me ligj. Kanë urdhëruar marrjen e 168 masave të afatizuara për të gjitha subjektet e vizituara kanë hartuar e dërguar 51 procesverbale.

ii. Brigada e zjarrfikësve

Ka realizuar detyrat dhe obligimet e planifikuara me Planin Vjetor të Punës. Kryesisht kjo njësi ka operuar në fushën e ndërhyrjeve me rastin e fatkeqësive elementare apo zjarreve të shkaktuara në territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Obiliqit. Gjatë vitit janë realizuar të gjitha trajnimet profesionale të planifikuara. Pra është realizuar trajnimi për ndihmë të parë në Vushtrri- 2 zjarrfikës, trajnimi për avancim-4 zjarrfikës, trajnimi për menaxhimin e vijës së parë-4 zjarrfikës, trajnimi për ngasje emergjente dhe aksidente në komunikacion-4 zjarrfikës, trajnimi për intervenime në zjarret fushoro- malore 2 zjarrfikës dhe trajnimi për intervenime në zjarret e brendshme 2 zjarrfikës. Ndërtimi i objektit të BZ-ës është në realizim e sipër, vlera e të cilit është 1.050.000,00€

iii. Pasqyra e intervenimeve të Brigadës së Zjarrfikësve

Gjatë vitit 2010	Numri i Zjarreve	Intervenime Teknike	Numri i zjarrfikësve pjesëmarrës	Numri i automjeteve të përdorura	Orë pune në angazhim
Gjithsejtë	908	232	3968	1544	5097,45

Gjatë intervenimeve për fikjen e zjarrit janë lënduar tre zjarrfikës. Për shkak të zjarreve janë lënduar edhe 49 qytetarë , kurse si pasojë e aksidenteve në trafik 7 qytetarë kanë vdekur.

Gjatë vitit 2010 janë pranuar 982 lëndë prej të cilave 487 njoftime, 181 aktvendime, 207 pëlqime, 51 lënde janë kthyer në drejtori tjera, 35 refuzime dhe 21 lënë në procedurë.

13. DREJTORIA E KADASTRIT

Drejtoria e Kadastrit është themeluar në fillim të vitit 2010. Vendimi për themelimin e kësaj drejtorie bazohet në numrin e madh të lëndëve që ka pasur sektori i kadastrit dhe gjeodezisë i cili ka qenë në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Kjo drejtori në fushë-veprimtarinë e vet ka mirëmbajtjen e operatit kadastral ku përfshihen: regjistrimi i pronës së paluajtshme, korrigjimin e regjistrimit të pronarëve, regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave, regjistrimin e banesave kolektive, pjesëve të etazhit si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë të vendosura banesat kolektive, ndarjen dhe bashkimin e ngastrave, incizimin e gjendjes dhe përkufizimin e patundshmërive, mirëmbajtjen e shenjat gjeodezike të ndarjeve të patundshmërive, ekspertizat e gjyqit, lëshimin e certifikatave mbi pronën e paluajtshme, kopjet e planit, lëshimin e vërtetimeve dhe certifikatave të ndryshme, zgjedhjen e kërkesave zyrtare nga gjykatat dhe institucionet të nivelit lokal dhe qendror dhe punët e tjera nga kompetencat të parapara më ligj, urdhëresa administrative dhe aktet të tjera nënligjore.

Angazhimi parësor i drejtorisë ka qenë ofrimi i shërbimeve më efikase për qytetarë duke garantuar të dhëna të azhurnuara për pronat. Si drejtorat i ri është punuar në:

- Sistemin e përgatitjes së të dhënave nga baza grafike dhe tekstuale,
- Kontrollimin e kualitetit të të dhënave para se të filloi shfrytëzimi i tyre,
- Arkivimi i rregullt i të dhënave kadastrale në bazën qendrore dhe lokale,
- Organizimin e matjeve kadastrale në teren sipas sistemit zyrtar “KosovaReff01”,
- Funksionalizimi i mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit në modelin zyrtar,
- Regjistrimi efektiv dhe i sigurt i pronave në Regjistrin të Drejtave për Posedim të Pronave (RDPP) etj.

Drejtoria ka pasur bashkëpunim shumë efektiv me “Agjencionin Kadastral të Kosovës (AKK)” dhe si rezultat është arritur marrëveshja për ndërtimin e “Rrjetit Referent të rendit të III-të” për zonat kadastrale të Prishtinës me gjithsej 550 pika të vendosura në terren, të cilat janë financuar nga AKK. Janë transformuar 69,865 pikave detale nga sistemi i vjetër “FryRef30” në sistemin e ri “KosovaRef01” për të gjitha zonat kadastrale nga Drejtoria e Kadastrit në AKK.

Është bërë arkivimi i fajllit të Gjeomedisë që ka involvuar lidhjen e të gjithë kompjuterëve në një server të përbashkët për qasje nga të gjithë gjeodetët për leximin, përpunimin dhe shfrytëzimin e të dhënave për terren. Janë transformuar të gjithë manualët që nga viti 2000 deri më 2010 nga sistemi i vjetër “AutoCad” në sistemin e ri “KosovaRef01” dhe është përfunduar me lidhjet e pikave të cilat janë futur në modelin digjital kadastral.

Gjatë vitit 2010 është filluar me regjistrimet e para të kadastrit etazher për objektet e reja për të cilat është lëshuar leja e përdorimit sipas kërkesave të qytetarëve. Duhet gjithashtu theksuar se pjesa grafike e kadastrit etazhor nuk evidentohet ende për shkak të mungesës së formularit i cili është në kompetencë të Agjencionit Kadastral të Kosovës, mirëpo kjo nuk paraqet pengesa për regjistrimin e kadastrit etazhor.

Në gjysmën e dytë të vitit 2010 ka filluar regjistrimi i ndërtesave, banesave, lokaleve dhe garazheve të cilat nuk kanë qenë të regjistruara. Ky projekt realizohet nga kompania

”Geoprojekt” e kontraktuar nga Banka Botërore. Realizimi i projektit është i planifikuar të përfundojë në gjysmën e parë të vitit 2011.

Janë mbajture disa takime me GTZ-në dhe si rezultat i këtij bashkëpunimi, me mbështetje edhe të AKK, Komuna e Prishtinës është përfituese e Projektit për përkrahjen e zhvillimit të Kadastrit në Kosovë 2011-2013 të quajtur “Menaxhimi i tokës/Kadastrit në Kosovë”. Në kuadër të këtij projekti, dy zyrtar vendor dhe një ndërkombëtar do të fillojnë punën në gjysmën e parë të vitit 2011 si dhe dhuruar 3 kompjuterë me kapacitete të duhuar për punët e kadastrit nga GTZ-ja gjermane.

Me formimin e komunave të reja (në bazë të Pakos së Ahtisarit) është krijuar edhe ajo e Graçanicës, e cila ka marrë gjashtë (6) Zona Kadastrale (ZK) si ne vijim: ZK Badovc me sip. prej 379.30.16 ha, ZK Graçanicë 1334.02.34 ha, ZK Llaplaselë 1118.09.91 ha, ZK- Proc 784.16.57 ha, ZK Shushicë 979.28.08 dhe ZK Qagllavicë 248.38.03 ha. Tani Prishtina tani posedon 52325.50.33 ha). Gjatë kësaj periudhe është bërë dorëzim-pranimi i lëndëve të kadastrit dhe janë realizuar të gjitha punët të parapara me Marrëveshjen e Mirëkuptimit e lidhure në mes të Komunës së Prishtinës, Komunës së Graçanicës dhe Ministrive përkatëse. Kemi realizuar disa takime me Zyrën Regjionale të Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP) për lëndët e pazgjedhura deri më tani.

Gjatë vitit 2010 kanë arritire një numër i madhe i kërkesave për realizimin e të drejtave pronësore nga persona fizik, juridik, gjykatat, AKK dhe AKP. Në vazhdim është paraqitur gjendjen e lëndëve të arritura, të aprovuare dhe lëndët të cilët janë në procedurë.

Tabela e lëndëve gjatë vitit 2010

	Pranuar	Aprovua	Në Procedurë	Të hyrat (€)
*Fletë poseduese dhe kopje e planit	19,407	19,407	0	73,944
* Certifikata/Vërtetime	17,292	17,292	0	558
RDPP - bartje	2,759	2,758	1	123,940
Korrigjime të të dhënave	93	93	0	1,860
Hipoteka-regjistrim	798	798	0	142,238
Hipoteka – çregjistrim	356	356	0	8,160
Ndarje e parcelave	559	472	72	57,724
Bashkimi i parcelave	20	20	0	400
Identifikim i parcelave	250	215	35	17,200
Ekspertiza	52	47	5	0
Kërkesa-Institucionet	575	575	0	0
*Te ndryshme	139	139	0	0
Gjithsejtë	42,300	42,187	113	417,024

* Lëndët të cilat nuk udhëhiqen në mes të Intranetit, por janë të regjistruara në regjistrat intern.

Vërejtje: (1) Nga lëndët e terrenit: të vitit 2006 janë aprovuara 2, të vitit 2007 është aprovuar 1, të vitit 2008 janë aprovuar 4 dhe 2009 janë aprovuar 63 lëndë.

(2) Për RDPP për periudhën 2003-2009 janë aprovuar 147 lëndë (10 me pronësi shoqërore) dhe 3 Revokime.

Në fushën e gjeomedisë profesionale është bërë trajnimi shtesë i disa punëtorëve nga ana AKK. Janë mbajtur 6 takime me trupat koordinuese (juristëve) rreth realizimit të lëndëve kryesisht në pronësi shoqërore, komunale dhe interpretimin ligjor për parcelimin e ngastrave kadastrale.

Me gjithë avancimin e angazhimeve, drejtoria megjithatë ka disa vështirësi në funksionimin edhe më të mirë të saj. Numri i punëtorëve nuk është i mjaftueshëm pasi mungojnë kryesisht juristët dhe gjeodetët për tu përball me rreth 180 kërkesa që arrijnë në ditë nga qytetarët dhe

institucionet e ndryshme. Problem i veçantë janë ende lëndët e pazgjedhura pronëso- juridike me vendime të gjykatave e të cilat lidhen edhe me AKP-në. Drejtoria ka identifikuar edhe nevojën për trajnim të stafit ekzistues si dhe pajisje me vetura dhe uniforma të gjeodetëve për terren si dhe sigurimi i vazhdueshëm i mirëmbajtjes dhe servisimit të instrumenteve gjeodezike që përdoren në terren.

14. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Aktiviteti i Drejtorisë së Inspektionit gjatë periudhës raportuese është orientuar në inspektimin e zbatimit të ligjit dhe të rregulloreve lokale të miratuara në Kuvendin Komunal që kanë të bëjnë: ndërtimtarinë, tregtinë, veprimtaritë komunale dhe të komunikacionit, bujqësinë, veterinarinë dhe sanitarinë. Punët e Drejtorisë së Inspektionit, janë bazuar në plan-programin e punës të paraparë për vitin 2010, por janë kryer edhe punë të tjera që janë paraqitur kohë pas kohe, në bazë të urdhërësave të organeve kompetente komunale, në bazë të kërkesave të qytetarëve, të ndërmarrjeve komunale shërbyese, si dhe në bazë të kërkesave të policisë.

a. Sektori i Tregut dhe i Bujqësisë

Inspektorët e sektorit të tregut dhe bujqësisë kanë kryer detyrat e parapara sipas planit vjetor, sipas urdhërësave të Kryetarit, shefit të administratës dhe personelit dhe drejtorit të Drejtoratit të Inspektionit dhe atë:

- Në kontrollimin e subjekteve afariste lidhur me regjistrimin e veprimtarisë së tyre në ZRBK – MTI-së, pajisjen e tyre me pëlqim të inspektionit për plotësimin e kushteve minimale teknike dhe sanitare higjienike si dhe pajisjen me leje të punës, sipas ligjit mbi tregtinë e brendshme.
- Në pranimin, shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave të pronarëve të bizneseve lidhur me plotësimin e kushteve minimale teknike dhe sanitare higjienike.
- Në pranimin , shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve dhe vendosjen e tyre konform kompetencave të sektorit dhe ligjit.
- Në organizimin e aksioneve për largimin e shitësve ambulant për rreth tregjeve, në rrugë, trotuare, hapësira publike në qytet.
- Kontrollimin e respektimit të fillimit dhe mbarimit të orarit të punës nga lëmi i tregtisë, hotelarisë, zejtarisë dhe shërbimeve në territorin e komunës së Prishtinës sipas rregullores e cila e trajton këtë lëmi.
- Në bashkëpunim me njësitin për krime me qenje njerëzore, kontrollimi i lokaleve të natës.
- Në bashkëpunim me inspektorët e ATK-së, në kontrollimin dhe largimin mallrave ushqimore dhe jo ushqimore nga qarkullimi – shitja me pakicë të cilat ka qenë të dëmtuara, felerike dhe jo korrekte për shitje dhe asgjësimi i tyre
- Kontrollimin e mallrave me prejardhje bimore – afatin e qëndrueshmërisë, cilësinë, sasinë dhe deklarimin e tyre dhe asgjësimin e mallit me afat të skaduar sipas ligjit mbi ushqimin.

Gjatë periudhës raportuese ka pasur 6,047 kontrollime, ku janë lëshuar 3,120 procesverbale. Nga këto kontrollime, 4,672 janë bërë në tregti, 706 në hoteleri, 85 në zejtari dhe 615 në shërbime të tjera. Është asgjësuar mall në vlerë prej 39,514 € Po ashtu është nxjerrë mall jashtë qarkullimit në vlerë prej 298,206€ Është konfiskuar mall ambulant në vlerë prej 4,675

€ Përkohësisht deri në eliminimin e të metave, marrjes së lejes së punës dhe pëlqimit, janë mbyllur 88 lokale.

Në kuadër të masave administrative janë ndërmarrë këto veprime:

- Urdhëresa me shkrim.....602,
- Vendime për mbyllje të lokaleve, asgjësim të mallrave dhe mallit jo korrekt të qitur jashtë qarkullimit..... 56,
- Fletëparaqitje për kundërvajtje111,
- Gjobat nga gjykata..... 21.950,
- Ankesa dhe kërkesa të qytetarëve të kryera.....30,

Drejtoria ka pranuar kërkesa për dhënien e pëlqimeve lidhur me plotësimin e kushteve minimale teknike nga kompetenca e inspeksionit të tregut si më poshtë:

- Të pranuar1445
- Të kryera 1090
- Në procedurë..... 53
- Të Refuzuara..... 7
- Me vërejtje dhe kontestuese..... 70
- Për bartje në vitin 2011..... 225.

Nga këto kërkesa janë inkasuar mjete në vlerë prej 111,794 €

b. Sektori i Ndërtimit

Në bazë të Ligjit për ndërtimin dhe në bazë të Udhëzimeve administrative, është bërë inspektimi i ndërtimeve në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe janë marrë masa ligjore për raste të ndryshme të ndërtimeve pa leje. Gjatë vitit 2010, ky sektor ka identifikuar 509 ndërtime pa leje, kur përfshihen të gjitha llojet e ndërtimeve (garazha, anekse të ndryshme, kate shtesë etj.). Të gjitha këto janë trajtuar nga inspektorët. Prej tyre 86 janë rrënuar nga komuna, 5 janë rrënuar nga vetë pronarët, janë nxjerrë edhe 138 aktvendime për rrënim dhe të tjerat janë në procedurë.

c. Sektori Sanitar dhe Veterinar

Aktiviteti i përhershëm i këtij sektori zhvillohet në drejtim të preventimit dhe të mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës nga sëmundjet e ndryshme infektive, pastaj në edukimin e popullatës për të aplikuar kulturën dhe masat mbrojtëse higjieno-sanitare, në ambientin jetësor. Gjatë periudhës raportuese në kuadër të këtij sektori ka pasur 2,339 kontrollime. Prej tyre janë përgatitur 992 procesverbale, janë nxjerrë 114 aktvendime, 232 rekomandime sanitare, 86 fletëparaqitje për kundërvajtje, 103 fletë-urdhëresa, janë lëshuar 448 libreta sanitare, janë marrë 42 mostra të ushqimit etj.

Malli i asgjësuar kap vlerën prej 448,040 € Shërbimi Veterinar ka zhvilluar ka kontrolluar mishin dhe produktet e mishit, qumështit dhe produkteve me prejardhje shtazore dhe ka bërë kontrollimin e zbatimit të ligjit mbi vaksinimin dhe rivaksinimin e shtazëve të mëdha dhe të imëta, qeneve dhe maceve në qytet si dhe dhënia – lëshimi i kartave të identitetit (pasaportave e qeneve dhe maceve).

d. Sektori Komunal dhe i Komunikacionit

Gjatë periudhës raportuese në kuadër të këtij sektori janë zhvilluar aksione në bashkëpunim me sektorin e Inspektoratit të Tregut dhe me mbështetjen e Policisë më qëllim të largimit nga rruga, nga trotuaret dhe nga hapësirat tjera publike të shitësve ambulantë, përreth tregut të gjelbërt dhe rreth tregut në lagjen Ulpiana. Janë zhvilluar aksione për largimin e shitësve ambulantë nga rruga dhe nga trotuaret përgjatë rrugëve “Nëna Terezë”, “Bulevardi i Dëshmorëve“, “Ilir Konushevci “ etj. Përmes aksioneve të përbashkëta me Drejtorinë e Financave dhe të Pronës, është bërë lirimi i pronave publike-komunale nga uzurpuesit në lagje të ndryshme të qytetit të Prishtinës.

Në kuadër të aktiviteteve dhe detyrave të përhershme në këtë sektor janë kryer edhe këto punë dhe detyra:

▪ Kontrollime.....	27.838
▪ Procesverbale.....	4529
▪ Aktvendime	638
▪ Fletëparaqitje për gjykatë.....	1025
▪ Kërkesa te palëve.....	436
▪ Njoftime te palëve me shkrim.....	106
▪ Aktpërcjelles (lende ne procedurë te mëtejme).....	24
▪ Aksione me SHPK-ne	390
▪ Aksione te ndryshme.....	353
▪ Fletëthirrje për palët.....	158
▪ Largim te reklamave-panove.....	610
▪ Largim te shtyllave anti-parking Largim te rrethojave metalike.....	227
▪ Largim te mbulojave te najlonit	02
▪ Largim i shitësve ambulant.....	297
▪ Largim te objekteve montuese.....	01
▪ Hapja e pusetave te kanalizimit	86
▪ Largim te tavolinave shërbyese nga sip-publike.....	19
▪ Evidentim (9) Komisione te shfrytëzimit te hap-publike para lokaleve.....	8
▪ Procesverbale me tikete te Policisë	177
▪ Kundërvajtje te ndryshme ne trafik	93
▪ Largim te rezervuarëve te naftës	01
▪ Dërgim shkresë -zyrtare	05

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. Nr. 031-423, më 02.03.2011

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Sami Hamiti, ecc. i dipl.